



Komisioni i Komunitetit Europian, për dhe
në emër të Qeverisë së Shqipërisë,

Ref.: EuropeAid/124909/C/SER/AL

Zbatimi i Planit Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit Mjedisor në Shqipëri

Komponenti B: Planifikimi i Zbatimit



30 Prill 2009

Ky raport është përgatitur nga ekipi i projektit që punon për Grontmij | Carl Bro nën iniciativën e financuar nga Bashkimi Europian CARDS 2006 .
Gjetjet, konkluzionet dhe interpretimet e shprehura në këtë dokument janë vetëm të Grontmij | Carl Bro dhe nuk pasqyrojnë në asnjë mënyrë opinionet dhe politikat e Komisionit Europian.

Komisioni i Komunitetit European,
për dhe në emër të Qeverisë së Shqipërisë,
Ref.: EuropeAid/124909/C/SER/AL
Zbatimi i Planit Kombëtar për
Përafrimin e Legjislacionit Mjedisor
në Shqipëri

PLANI I ZBATIMIT TË DIREKTIVËS SPECIFIKE

Direktiva mbi Trajtimin e Ujërave Urbane të Ndotura (91/271/KEE)

Autorë:

Paolo Bacca, Norman Sheridan, Hans Bruins, Jonathan Pearse

Falenderime:

Ekipi i projektit dëshiron t'u shprehë falenderime e mirënjohje të gjithë personave informues e ekspertëve nga të gjitha institucionet dhe aktorëve të përfshirë në mbledhjen e të dhënave dhe informacionit si edhe të gjithë personave dhe organizmave që kanë mbështetur hartimin e këtij Raporti. Falenderime të veçanta i jepen Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe stafit të saj të specialistëve.

Përmbajtja e Lëndës

Fjalori i termave	4
Hyrje	7
Përmbledhje Ekzekutive	9
1 Kërkesat e Legjislacionit të BE-së	14
1.2 Legjislacioni i BE-së i trajtuar	14
1.3 Kërkesat Direkte të Legjislacionit	14
1.4 Kërkesat / Implikimet Indirekte	16
1.5 Lidhjet me Legjislacione të tjera në Këtë Sektor	16
2 Situata Aktuale	18
2.1 Politika Qeveritare	18
2.2 Rolet & Përgjegjësitë	19
2.3 Kuadri Ligjor Aktual	22
2.4 Statusi Aktual i Zbatimit – Analiza e Boshllëqeve Ligjore	22
2.5 Gjendja Aktuale e Investimeve	23
2.5.1 Ujësjiellësi Publik (Furnizimi me ujë)	23
2.5.2 Kanalizimet dhe trajtimi i ujërave të ndotur	29
2.5.3 Planet në vijim për administrimin e ujërave urbanë të ndotur	29
2.5.4 Administrimi i ujërave industrialë të ndotur	29
3 Plani i Përafrimit	32
3.1 Plani i Përgjithshëm dhe Afatet e Realizimit të Objektivave	32
3.2 Plani i Transpozimit	33
3.3 Plani i Zbatimit	34
3.4 Plani paraprak i investimit për infrastrukturën e ujërave të ndotur	44

3.4.1	Përzgjedhja e aglomerateve	44
3.4.2	Përzgjedhja e zonave sensitive dhe të mbrojtura	46
3.4.3	Projektimi paraprak dhe përlogaritja e kostove për sistemet e grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur	47
4	Burimet dhe Kostot e Përgjithshme	51
4.1.1	Hyrje	51
4.1.2	Metoda e përlogaritjes së kostos dhe burimet për të dhënat e kostos	51
4.1.3	Hamendësimet e bëra	52
4.1.4	Kostot e përlogaritura për transpozimin	53
4.1.5	Kostot e përlogaritura për zbatimin	53
4.2	Strategjia e Financimit	59
4.2.1	Hyrje	59
4.2.2	Burimet e financimit – Të përgjithshëm	59
4.2.3	Financimi i kostove	66
4.3	Përfitimet	69
4.4	Çështjet kryesore dhe Pasiguritë	70
	Referenca	73

Lista e Akronimeve

Nen.	Neni
AJBN	Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar
AK	Autoriteti/et kompetente
AT	Asistencë Teknike
BE	Bashkimi Europian
BERZH	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BNRZH	Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
DKU	Direktiva Kuadër mbi Ujërat
DPUK	Drejtoria e Përgjithshme e Ujësllës Kanalizime
DTUUN	Direktiva mbi Trajtimin e Ujërave Urbanë të Ndotur
e.p.	ekuivalenti i popullimit (ngarkesa e ujit të ndotur prej 60 g KBO5 në ditë)
epkp	ekuivalent i person me kohë të plotë
FEZHR	Fondi Europian për Zhvillim Rajonal
FK	Fondi i Kohezionit
Ha	Hektar
IAP	Instrument për Asistencën Para-Pranimit (në BE)
ITUN	Impjant për Trajtimin e Ujërave të Ndotur
KB	Kombet e Bashkuara
KBO5	Kërkesa biokimike 5 ditore për oksigjen
KEE	Komuniteti Ekonomik Europian
KEpE	Komisioni Ekonomik për Europën
KNI	Kontrolli i Ndotjes Industriale
LIBOR	Norma e Interesit Ofruar nga Interbank në Londër
LMPSH (projekti)	Legjislacioni Mjedisor dhe Planifikimi në Shqipëri
LNU	Ligji mbi Ndotjen e Ujërave
MF	Ministria e Financave
MMPAU	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave
MPPTT	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
N	Azoti
NSHT	Ndërto-Shfrytëzo-Transfero
P	Fosfori
PKIN	Parandalimi dhe Kontrolli i Integruar i Ndotjes
PKNP	Parimi Kush Ndot Pagan
PZDS	Plani i Zbatimit të Direktivës Specifike
SHNZH	Shoqatë Ndërkombëtare Zhvillimi
SHRA-10	10 shtetet e reja anëtare që u pranuan në BE në 2004
SIGJ	Sistem informativ gjeografik
SSHSUUN	Strategjia e Shqipërisë për Sektorin e Ujësllësit dhe Ujërave të Ndotur
SSMNS	Strategjia e Sektorit Mjedisor dhe ajo Ndër-Sektoriale
TUUN	Trajtimi i Ujërave Urbanë të Ndotur
USD	Dollar Amerikan
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Fjalori i termave

Aglomerat

Qendër e banuar ose zonë me përqëndrim të mjaftueshëm popullsie dhe / ose aktivitetesh ekonomike e tillë që ujërat urbane të ndotura të grumbullohen dhe të transferohen në një impjant për trajtimin e ujërave urbane të ndotura (ITUUN) ose në një pikë finale shkarkimi. Një aglomerat mund të përbëhet nga një ose disa qendra të banuara, të cilat për shembull janë vendosur në të njëjtin basen kullues hidrologjik në mënyrë të tillë që shkarkimi i ujërave të ndotur nga qendrat e banuara të aglomeratit tek një ITUN qëndror mund të rezultojë në zgjidhjen më ekonomike.

Për identifikimin e aglomerateve të gjitha qendrat e banuara urbane me një popullsi prej ≥ 1000 banorë duhet të zgjidhen nga të dhënat mbi statistikat e popullsisë. Këto qendra të banuara janë shenjuar në harta, dhe në bazë të vlerësimit të prototipeve kulluese natyrore sipas zonave, vlerësohet nëse qendrat e banuara mund të kombinohen në aglomerate prej më shumë se 2000 EP, të cilave mund t'u shërbejë një ITUN qëndror. Efektiviteti i kostos është kriter dominues në përcaktimin e aglomerateve duke marrë parasysh se kostot e disa ITUN të vogla janë më të larta se kostoja e një ITUN më të madh që trajton të njëjtën ngarkesë uji të ndotur, si përsa i përket investimit ashtu edhe kostove operative.

Kriteret për përzgjedhjen dhe formimin e aglomerateve janë:

- Qendrat e banuara me më shumë se 1000 banorë janë identifikuar si qendra potenciale aglomerati
- Kombinimi i qendrave të banuara në zonën përfshirëse të një aglomerati nëse distanca midis qendrave të banuara është më e vogël se 10 km dhe nëse është e mundur praktikisht që këto qendra të banuara të lidhen me ITUN qëndror me tuba transportues për ujërat e ndotura nëpërmjet forcës së rëndesës ose trysnisë (në bazë të vlerësimit të situatës kulluese natyrore në zonën e aglomeratit). Kriteret në këtë drejtim janë:
 - Qendrat e banuara janë lokalizuar në të njëjtën zonë përfshirëse me karakteristika kulluese natyrore
 - Mungesa e pengesave fizike për të bashkuar qendrat e banuara me njëra tjetrën ose qendrat e banuara me ITUN qëndror
 - Prova që transportimi i ujërave të ndotura nga qendrat e banuara në ITUN qëndror ka më shumë leverdi ekonomike sesa shfrytëzimi i një ITUN të pavarur për qendër të banuar.

Eutrofikim

Rritja e tepërt e algave dhe formave të tjera bimore në sipërfaqen e ujit për shkak të përqëndrimeve të larta të ushqyesve (veçanërisht azotit dhe fosforit) gjë që shkakton një prishje të padëshiruar të balancës së organizmave të pranishme në ujë dhe të cilësisë së vetë ujit; eutrofikimi ndodh kryesisht në ujërat e qeta siç janë liqenet dhe kanalet me një shpejtësi të vogël rrjedhe. Ujërat që janë të ndjeshëm ndaj eutrofikimit do të shpallen zona sensitive në këndvështrimin e Direktivës TUUN.

Ekuivalenti i popullimit

Ekuivalenti i popullimit (e.p.) përdoret si një njësi për të shprehur ngarkesën organike të biodegradueshme të ujërave të ndotura, që përbëhet nga një përzierje ujërash të ndotura nga burime të ndryshme, p.sh. shtëpiake, industriale, etj. Një e.p. përkufizohet si ngarkesa organike e biodegradueshme që e ka kërkesën biokimike pesë ditore për oksigjen të barabartë me 60 g oksigjen në ditë (1 e.p. = 60 g KBO₅).

Zonat Sensitive

Zonat sensitive janë identifikuar si:

- trupa ujqorë (trupat me ujë të ëmbël, ujërat estuarë - grykajat e lumenjve- dhe bregdetarë) të cilët janë eutrofikë ose të ndjeshëm për t'u bërë eutrofikë.
- ujërat sipërfaqësorë që përdoren si burime uji të pijshëm që kanë potencialisht përqëndrim shumë të lartë nitrati ashtu siç përshkruhet në Direktivën 75/440/KEE (50mg/l nitrat)
- zonat ku trajtimi i mëtejshëm përveç atij të përshkruar në Nenin 4 është i nevojshëm me qëllim që të përmbushë Direktivat e tjera të Këshillit

Në këtë raport është zgjeruar përkufizimi i Direktivës mbi TUUN për zonat sensitive. Të gjitha zonat e mbrojtura, p.sh. parqet natyrore, rezervat pyjore; trupat ujqorë të klasifikuar, zonat Natyra 2000 dhe zonat e mbrojtura me ujë të pijshëm, konsiderohen të kenë plotësuar të paktën kërkesat për zonat sensitive.

Zonat më pak sensitive

Një trup ose zonë ujqore marine mund të identifikohet si një zonë më pak sensitive nëse shkarkimi i ujërave të ndotura nuk ndikon negativisht në mjedis. (Deti Adriatik nuk është një zonë më pak sensitive.)

Sistemi i kanalizimeve

Rrjeti i tubacioneve dhe tubave të tjerë për të grumbulluar ujërat e ndotur nga shtëpitë, industrinë, institucionet, etj., dhe / ose ujërat e tepërt nga shiu, dhe për të transportuar ujërat e ndotura në një pikë qendrore depozitimi, p.sh. një impjant për trajtimin e ujërave të ndotur. Në përgjithësi, rrjedha e ujërave të ndotura në sistemin e kanalizimeve ndodh për shkak të forcës së rëndësës, por nëse është e nevojshme përdoren pompa për të ngritur ujërat e ndotur në një pikë më të lartë me qëllim që të përmirësohet transportimi i mëtejshëm. Në një sistem të kombinuar kanalizimesh ujërat e ndotura dhe uji i shiut grumbullohen në të njëjtin rrjet. Në sistemet e veçanta të kanalizimeve, ka rrjete të veçanta tubacionesh për grumbullimin e ujërave të ndotur dhe ujit të shiut.

Impjanti i trajtimit të Ujërave të Ndotur

Ujërat e ndotur ose përzierja e ujërave të ndotur me ujin e shiut, shkarkuar nga sistemi i kanalizimeve, futen për t'u trajtuar në një impjant për trajtimin e ujërave të ndotur, me qëllim që të prodhohen efluentë (mbetje të lëngëta) me cilësi specifike siç kërkohet nga standartet vendore të cilësisë që mbizotërojnë për shkarkimin në mjedisin bujtës, p.sh. në një trup me ujëra sipërfaqësorë ose në tokë. Trajtimi i ujërave të ndotur, në përgjithësi, ndodh sipas hapave të mëposhtme:

- Monitorimi – largimi i materialeve të ashpra
- Largimi i gurëve ranorë – largimi i copave të mëdha të cilat zenë vend lehtësisht
- Largimi i lubrifikantëve – largimi i substancave pluskuese, vaj dhe lubrifikantë
- Sedimentimi primar – largimi i lëndëve të ngurta nga ujërat e ndotura. Llumi i precipituar mund të trajtohet me digjestion anaerobik. (Në lloje të veçanta ITUN hapi i sedimentimit primar nuk kryhet.)
- Trajtimi sekondar – oksidimi biologjik i lëndëve organike në ujërat e ndotur me formacione llumi me mikro-organizma aerobike (llum aktiv). Oksidimi (i pjesëshëm) i substancave organike me azot (nitrifikimi) dhe reduktimi i nitratit në gazin e azotit (de-nitrifikimi).

- Trajtimi terciar – trajtimi i mëtejshëm për largimin e përbërjeve të azotit dhe fosforit nëpërmjet proceseve biologjike dhe / ose kimike.
- Sedimentimi sekondar – sedimentimi i likidëve të përzierë të llumit aktiv me ujërat e ndotur me formacione llumi dhe efluentë (mbetje të lëngëta).
- Rafinimi i efluentëve (mbetjeve të lëngëta) – trajtim shtesë i efluentëve (mbetjeve të lëngëta) para shkarkimit, p.sh. për largimin e patogjenëve, lëndëve të paqëndrueshme dhe përbërjeve të rrezikshme.
- Trajtimi i llumit – trashja, largimi i ujit dhe tharja e llumit nga rezervuarët e sedimentimit primar dhe sekondar, ndjekur nga depozitimi në fushëgrumbullim (landfill) ose incinerimi.

Hyrje

Ky raport prezanton rezultatet e vlerësimit ligjor, administrativ dhe institucional mbi gjendjen aktuale për përafrimin me: *Direktivën e Këshillit 91/271/KEE në lidhje me trajtimin e ujërave urbanë të ndotur, amenduar nga Direktiva e Komisionit 98/15/KE*, dhe planin e përgjithshëm për të realizuar përafrimin e plotë në përgatitjen e vendit për të hyrë në BE.

Raporti hedh dritë mbi boshllëqet dhe problemet / dobësitë që mund të pengojnë transpozimin dhe zbatimin efektiv të Direktivës dhe, prandaj, identifikon zgjerimin e kapaciteteve të nevojshme për të siguruar zbatimin e saj efektiv dhe eficient. Raporti gjithashtu ofron përlllogaritjet më të mira që mund të bëhen aktualisht për sa i përket kostove dhe përfitimeve.

Raporti ravigon një plan paraprak për të realizuar përpunimin e plotë me kërkesat për investime që lindin nga Direktiva mbi Trajtimin e Ujërave Urbanë të Ndotur. Si i tillë, plani fokusohet tek aglomeratet e përzgjedhura me një ngarkesë potenciale të ujërave të ndotur me ekuivalent popullimi prej më shumë se 2000 (e.p.), dhe tek industritë e mëdha agro-ushqimore që gjenerojnë ngarkesa uji të ndotur me ekuivalent popullimi prej më shumë se 4000 e.p., të cilat janë lokalizuar jashtë aglomerateve urbane.

Raporti mbështetet në shqyrtimin e të dhënave dhe dokumentacionit përkatës të disponueshëm (përfshirë informacionin mbi numrin e popullsisë, sistemet e furnizimit me ujë të publikut, sistemet e kanalizimeve, industritë dhe impiantet e trajtimit të ujërave të ndotur, i cili është mbledhur nëpërmjet një pyetësoi dërguar bashkive dhe komunave), si edhe në kontaktet e shumta dhe diskutimet e hollësishme të zhvilluara si ndërmjet anëtarëve të Ekipit të Asistencës Teknike (EAT) ashtu edhe midis anëtarëve të EAT dhe një game të gjerë zyrtarësh në pozicione të rëndësishme.

Raporti ndahet në 4 pjesë kryesore.

Pjesa 1 paraqet një pasqyrë përmbledhëse të Direktivës.

Pjesa 2 përmbledh situatën ekzistuese në Shqipëri në lidhje me përafrimin e kësaj Direktive, që përfshin:

- i) Analizën e boshllëqeve ligjore;

- ii) vlerësimin e gjendjes së sistemeve ekzistuese të grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur si edhe inventarit të nevojave për përmirësim dhe zgjerim;
- iii) vlerësimin e sistemeve ekzistuese të furnizimit me ujë të publikut;
- iv) inventarin e qendrave të banuara me më shumë se 1000 banorë si bazë për identifikimin dhe përzgjedhjen e aglomerateve;
- v) inventarin e industrive që gjenerojnë ujëra të ndotur të biodegradueshëm me një ngarkesë uji të ndotur prej ≥ 4000 e.p.

Pjesa 3 diskuton mbi mekanizmat e zbatimit dhe nxjerr disa rekomandime për plotësimin e përafrimit të Direktivës, që përfshijnë:

- i) Zgjedhjen e zonave sensitive dhe më pak sensitive në përputhje me Direktivën, dhe zonave të mbrojtura për të cilat mbizotërojnë rregullore të veçanta për asgjësimin e ujërave të ndotur;
- ii) Identifikimin dhe përzgjedhjen e aglomerateve;
- iii) Ravijimin e planit të investimit dhe veprimit për zhvillimin e sistemeve të grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur për aglomeratet dhe industrinë dhe për modernizimin e sistemeve ekzistuese të grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur.

Përlllogaritja e kostove treguese të zbatimit është prezantuar në Pjesën 4, e cila përfshin llogaritjen e kostove për sistemet e kanalizimeve dhe impjantet për trajtimin e ujërave të ndotur për aglomeratet e propozuara.

Përmbledhje Ekzekutive

Direktiva 91/271/KEE, amenduar nga Direktiva 98/15/KE, mbi trajtimin e ujërave urbane të ndotura (TUUN) lidhet me grumbullimin, trajtimin dhe shkarkimin e ujërave urbane të ndotur si edhe trajtimin e shkarkimin e ujërave të ndotur nga sektorë të caktuar industrialë.

Kërkuesat e Direktivës mund të përmbledhen si më poshtë:

Sistemet grumbulluese: duhet të ofrohen për të gjitha aglomeratet me ngarkesë uji të ndotur prej 2000 e.p. ose më shumë.

Trajtimi i ujërave urbane të ndotur: Sipas termave për standartet e trajtimit, rregulli i përgjithshëm është trajtimi sekondar. Trajtimi i avancuar kërkohet për largimin e niveleve më të larta të azotit dhe fosforit në zonat sensitive.

Shkarkimi i ujërave të ndotur të trajtuar duhet të jetë subjekt i rregulloreve dhe / ose autorizimeve të veçanta të marra më parë. Ujërat e ndotura të trajtuara duhet të ripërdoren sa herë që është e përshtatshme. Rrugët e depozimit të ujërave të ndotur të trajtuar duhen zgjedhur në mënyrë të tillë që të minimizojnë efektet negative në mjedis. Impjantet e trajtimit duhet të projektohen ose modifikohen në mënyrë të tillë që kampionet përfaqësuese të ujërave hyrës të ndotur dhe ato të efluentëve (mbetjeve të lëngëta) të trajtuar të mund të përftohen para se të shkarkohen tek ujërat bujtëse.

Autoriteti kompetent ose organet e dhura duhet të monitorojnë shkarkimet nga impjantet e trajtimit të ujërave urbane të ndotura. Direktiva përcakton rregjimet minimale për marrjen e kampioneve si edhe metodat referencë të matjeve.

Ujërat industriale të ndotura: shkarkimet në sistemet grumbulluese dhe impjantet e trajtimit UUN duhet t'i nënshtrohen rregulloreve dhe / ose autorizimeve të veçanta të marra më parë. Ujërat industriale të ndotura duhet të para-trajtohen, nëse kërkohet.

Zonat sensitive: një trup ujqor duhet identifikuar si zonë sensitive (Direktiva TUUN Aneksi IIA) nëse:

- Është eutrofik ose mund të bëhet eutrofik në të ardhmen e afërt nëse nuk merren masa mbrojtëse, ose
- Është ujë i ëmbël sipërfaqësor që përdoret për nxjerrjen e ujit të pijshëm dhe përqëndrimi i nitratis mund të jetë më i lartë se 50mg/l nitrate (siç parashtrohet në Direktivën 75/440/KEE në lidhje me cilësinë e kërkuar për ujërat sipërfaqësorë të destinuar për nxjerrjen e ujit të pijshëm) nëse nuk merren masa, ose

- Është një zonë ku kërkohet trajtimi i mëtejshëm me qëllim që të përmbushen detyrimet e Direktivave të tjera.

Identifikimi i zonave sensitive duhet të rishikohet çdo 4 vjet.

Zonat më pak sensitive: mund të përcaktohen sipas kriterëve të vendosura në Direktivë. Shkarkimet në zonat më pak sensitive mund të kërkojnë trajtim më pak rigoroz, me kusht që të kryhet të paktën trajtimi primar.

Analiza e Boshllëqeve Ligjore

Neni 28 i Ligjit Nr. 8093, datë 21.03.1996 “Mbi burimet ujore” përcakton bazën ligjore të kuadrit rregullator të ujërave të zeza.

Ligji Nr. 9115/2003 “Mbi Trajtimin Mjedisor të Ujërave të Ndotur” është pjesa kryesore e legjislacionit mbi kërkesat për trajtimin e ujërave të ndotur.

Neni 6 i Ligjit mbi Burimet Ujore parashikon që K KU **NCW** të propozojë projekt ligje dhe rregullore “mbi çdo lloj aktiviteti në fushën e rezervave ujore” dhe të përgatisë “kuadrin ligjor, teknik dhe rregullator për aplikimin e këtij ligji”. (Vini re se ky Nen 6 nuk thotë se kujt ia propozon rregulloret K KU **NCW**).

Klauzolat kryesore të Direktivës që nuk janë transpozuar përfshijnë: Detyrimet e Nenit 3.1 në lidhje me sistemet grumbulluese; Kërkesat e Nenit 4.1 për madhësinë e aglomerateve dhe nivelet e trajtimit; legjislacioni kombëtar në lidhje me Nenin 11 mbi ujërat industriale të ndotura është pothuaj i paqartë; nuk ka kërkesa të qarta për lejet siç përcaktohet në Nenin 13 për Industrinë në Aneksin III; Kërkesat e Nenit 14 në lidhje me depozitim të llumrave.

Plani i Përafrimit

Plani i përgjithshëm për të realizuar përafrimin e plotë përbëhet nga një plan transpozimi ligjor dhe një plan zbatimi (që përfshin detyrimin për zbatim):

- **Plani i transpozimit ligjor** konsiston në hartimin e një VKM-je që do të anullopë dhe zëvendësojë VKM-në ekzistuese 177/2005. Arsyetimi për këtë diskutohet në detaje më poshtë.
- **Plani i zbatimit** përbëhet nga një sërë masash të cilat janë konsoliduar në një nga pesë grupet kryesore të masave si më poshtë:
 - a) Forcimi institucional dhe ngritja e kapaciteteve;
 - b) Puna përgatitore;
 - c) Mbledhja dhe trajtimi i ujërave të ndotur;
 - d) Depozitimi i llumrave dhe ujërave të ndotur të trajtuar; dhe
 - e) Monitorimi, mbajtja e të dhënave dhe raportimi.

Është hartuar një plan paraprak investimi për grumbullimin e ujërave urbane të ndotura dhe infrastrukturën për trajtimin e tyre. Është përilogaritur që plani mund të ekzekutohet në një periudhë kohore prej 15 deri 20 vjetësh.

Ky plan paraprak është zhvilluar në etapat e mëposhtme:

- Identifikimi i aglomerateve urbane sipas zonave të baseneve të lumenjve në bazë të të dhënave të popullsisë dhe informacionit gjeografik.
- Vlerësimi i nevojave për sistemet e grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur bazuar në informacionin e strukturave ekzistuese.

- Zgjedhja e zonave sensitive dhe zonave të tjera me kërkesa specifike për mbrojtjen e burimeve ujore.
- Projektimi paraprak dhe llogaritjet e kostove për sistemet e grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur për aglomeratet.

Në Tabelën e mëposhtme jepet një pasqyrë e aglomerateve të përzgjedhura.

Përmbledhje e aglomerateve të përzgjedhura

Rajonet e baseneve të lumenjve	Numri i komunave	Numri i Aglomerateve	Ngarkesa e ujit të ndotur (e. p.)
Seman	99	49	626,800
Drin-Shkodër-Bunë	81	42	288,200
Mat	36	24	173,200
Ishëm-Erzen	44	25	1,328,300
Shkumbin	47	28	278,700
Vjosë	67	28	286,500
Totali	374	196	2,981,700

Në Shqipëri, trupat ujqorë, që janë sensitive për eutrofikim, nuk janë përzgjedhur ende. Aktualisht, nuk ekzistojnë të dhëna të mjaftueshme për të shpallur zonat sensitive siç kërkohet nga Direktiva TUUN. Për momentin presupozohet se të gjitha trupat ujqorë sipërfaqësorë do të shpallen si 'zona sensitive' në sensin e Direktivës deri sa të merren vendime zyrtare mbi këtë çështje.

Për secilin nga aglomeratet, kostot paraprake të investimit për sistemet e grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur janë përlllogaritur si më poshtë:

- Për aglomeratet midis 2,000 dhe 10,000 e.p. kostot janë llogaritur në bazë të trajtimit konvencional.
- Për aglomeratet më të mëdha se 10,000 e.p. kostot janë llogaritur në bazë të trajtimit të avancuar me efikasitet më të lartë largimi të Azotit dhe Fosforit me qëllim që të përmbushen kërkesat e cilësisë për efluentët (mbetjet e lëngëta) për shkarkimin në zonat sensitive.
- Për aglomeratet e vogla mund të konsiderohen gjithashtu metoda trajtimi alternative për ujërat e ndotur, siç janë sistemet e húrthive / pellgjeve dhe ligatinave artificiale të cilat mund të rezultojnë në një reduktim të dukshëm të kostove të ndërtimit dhe ato operacionale. Zgjedhja e sistemeve të tilla varet kryesisht në disponibilitetin e hapësirës tokësore të përshtatshme.

Të dhënat për 3 kategoritë e ndryshme sipas diapazonit të madhësisë së aglomeratit janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Kategoritë sipas diapazonit të madhësisë së aglomeratit

Diapazoni i madhësisë (e.p.)	Nr. i Aglomerateve	Ngarkesa totale e ujit të ndotur (e.p.)	Kostot e Investimit (€)	
			ITUN	Kanalizime
I. > 20000	19	2,172,000	333,120,000	564,590,000
II 5000 - 20000	59	486,800	170,311,800	244,730,200
III. 2000 - 5000	118	322,900	180,073,100	172,395,600

TOTALI	196	2,981,700	683,504,900	981,715.800
---------------	------------	------------------	--------------------	--------------------

Kostot paraprake të llogaritura për investim në sistemet e grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të përdorur për aglomeratet jepet më poshtë.

Kostot paraprake të llogaritura për investim (në Euro)

	Punime Civile	Fondi i Kontigjencës (Rezervë)	Projekti, mbikqyrja, Sigurimi i cilësisë /standarteve të ndërtimit	Totali
ITUN	683,504,900	68,350,490	136,700,980	888,556,370
Sistemet e grumbu-llimit	981,715,800	294,514,740	196,343,160	1,472,573,700
TOTALI	1,665,220,700	362,865,230	333,044,140	2,361,130,070

Burimet dhe Kostot e Përgjithshme

Është bërë një përlllogaritje e kostove për masat e ndryshme që duhen marrë për të përafruar dhe zbatuar Direktivën mbi Trajtimin e Ujërave Urbanë të Ndotur.

Kostot e llogaritura për transpozimin: Burimet njerëzore për hartimin e dokumentave ligjore në MMPAU do të jenë nën trysni në vitet e ardhshme, edhe nëse rriten kapacitetet. Do të ishte me vend të merrej në konsideratë një projekt asistence teknike për të mbështetur Ministrinë në këtë detyrë. Është llogaritur se projekti i asistencës teknike do të ketë një kosto të përafërt prej €300,000.

Kosto e llogaritura për zbatimin: Zbatimi i Direktivës për Trajtimin e Ujërave Urbane të Ndotur do të jetë përgjegjësi e autoritetit kompetent i caktuar për të zbatuar Direktivën në nivel kombëtar dhe lokal.

Kostot e përgjithshme të llogaritura për zbatimin e Direktivës janë treguar në tabelën e mëposhtme.

Kostot Totale të zbatimit të Direktivës TUUN, sipas agjencisë/sektorit përgjegjës

Agjencia/sektori përgjegjës	Kostot kapitale / që ndodhin vetëm një herë ¹ (€000)	Kosto Operacionale / që përsëriten (€000/vit)
Qeveria Shqiptare	1,600	-
MMPAU	7,240	82
MPPTT	-	29
Agjenci Mjedisore	-	14
Bashkitë	2,377,782	49,683
Industria	37,500	1,875
Totali	2,424,122	51,683

Duket se zbatimi i Direktivës mbi Trajtimin e Ujërave Urbanë të Ndotur do të jetë jashtëzakonisht i kushtueshëm. Kostot totale të zbatimit përbëhen nga kostot kapitale prej €2,400 milionë dhe kostot operative të cilat arrijnë përfundimisht në €52 milionë për vit. Kjo kosto është e barasvlefshme me rreth 10% të PBB vjetor. Kostot janë treguar në tabelë sipas palës përgjegjëse kryesore (në vend të parë) për aktivitetin. Pjesa dërrmuese do të jetë përgjegjësi e bashkive. Kjo për arsye se në hamendësimet e bëra do të jetë përgjegjësi e bashkive jo vetëm të shfrytëzojnë dhe mirëmbajnë infrastrukturën sanitare, por edhe të kryejnë investimin e kërkuar.

Kjo nuk do të thotë që bashkitë do të duhet t'i mbulojnë këto kosto nga burimet e tyre. Përfundimisht kostot bashkiake të shtuara do të rikuperohen nga përdoruesit e shërbimeve sanitare në formën e taksave më të larta sanitare / dhe të ujit. Në periudhën afatshkurtër deri atë afatmesme, kur këto kosto rriten shumë, bashkitë mund të kërkojnë të marrin mbështetje në formën e granteve dhe kredive të buta nga BE, IFN dhe organizma të tjerë bilateralë dhe multilateralë që ofrojnë ndihmë.

¹ Të gjitha kostot janë llogaritur me çmimet konstate të vitit 2008.

1 Kërkesat e Legjislacionit të BE-së

1.2 Legjislacioni i BE-së i trajtuar

Legjislacioni i BE-së i trajtuar në këtë plan zbatimi është:

- *Direktiva e Këshillit 91/271/KEE në lidhje me trajtimin e ujërave urbanë të përdorur, e amenduar nga Direktiva e Komisionit 98/15/KE.*

Direktiva ofron një kuadër për grumbullimin, trajtimin dhe shkarkimin e ujërave urbanë të ndotur nga qendrat e populluara (përkrahur në Direktivë si aglomerate), dhe trajtimin dhe shkarkimin e ujërave të ndotur të biodegradueshëm nga sektorë të caktuar industrialë. Objektivi i kësaj direktive është të mbrojë mjedisin nga efektet negative të shkarkimeve të tilla të ujërave të ndotur. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që ujërat urbanë të ndotur të mblidhen dhe trajtohen para se të shkarkohen sipas standarteve dhe afateve specifike. Përsa i përket objektivave të trajtimit, rregulli i përgjithshëm është trajtimi sekondar (p.sh. biologjik), kombinuar me largimin e ushqyesve shtesë në të ashtu-quajturat zona sensitive (trajtimi terciar); megjithatë, për zona të caktuara marine trajtimi primar mund të jetë i mjaftueshëm. Afatet për zbatimin e Direktivës variojnë sipas madhësisë së aglomeratit dhe karakteristikave të ujërave bujtëse.

1.3 Kërkesat Direkte të Legjislacionit

Direktiva detyron për sa më poshtë Shtetet Anëtare të:

- Identifikojnë zonat sensitive (dhe më pak sensitive²) në lidhje me shkarkimin e ujërave urbanë të ndotur, në përputhje me kriteret e specifikuar, dhe rishikon identifikimin e këtyre zonave çdo katër vjet (Neni 5 dhe 6 dhe Aneksi II). Direktiva Kuadër mbi Ujërat (2000/60/KE) përcakton kërkesat për identifikimin e këtyre zonave, krijimin e planeve të administrimit të baseneve të lumenjve dhe kërkesat raportuese;
- Forcojnë kapacitetet teknike dhe financiare duke hartuar një program teknik dhe financiar për zbatimin e Direktivës (Neni 17). Direktiva Kuadër mbi Ujërat (Neni 9) përkrahur se si mund të aplikohet rikuperimi i kostos për shërbimet e ujit (Parimi Kush Ndot Pagan);

² Nuk pritet që në Shqipëri të ketë ndonjë zonë më pak sensitive

- Forcojnë kontrollin rregullator për ujërat e ndotur urbanë dhe industrialë duke marrë më parë autorizime ose rregullore specifike për të gjitha shkarkimet e ujërave urbanë të ndotur. (Neni 12, Aneksi IB), dhe të ujërave të ndotur industrialë nga sektori agro-ushqimor (Neni 13, Aneksi III), ashtu si edhe për të gjitha shkarkimet e ujërave të ndotur industrialë në sistemet urbane të grumbullimit dhe impjantet e trajtimit (Neni 11, Aneksi IC). Direktiva përshkruan kërkesat për rishikimin e lejeve dhe autorizimeve dhe në cilat situata mund të lejohen amendimet dhe shfuqizimet e pjesshme të ligjit;
- Grumbullojnë ujërat e ndotur urbanë dhe industrialë duke siguruar që sistemet për grumbullimin e ujërave të ndotur ofrohen për të gjitha qendrat e populluara (aglomeratet) me një e.p. 2,000 ose më shumë (Neni 3 dhe Aneksi IA);
- Trajtojnë ujërat e ndotur urbanë dhe industrialë duke siguruar që impjantet e trajtimit janë projektuar, ndërtuar, shfrytëzuar dhe mirëmbajtur (ose përmirësuar) që të plotësojnë kërkesat specifike të performancës (Neni 10). Sigurojnë që trajtimi sekondar i ujërave të ndotur (Neni 4 dhe Aneksi IB, Tabela 1) ofrohet për të gjitha qendrat e populluara (aglomeratet me një e.p. 2,000 ose më shumë) brenda afateve të përcaktuara në Direktivë. Niveli i trajtimi duhet të jetë më rigoroz për shkarkimet në zonat sensitive, i cili përveç trajtimit sekondar kërkon largimin e ushqyesve (azotit dhe fosforit) dhe eliminimin e çdo lloji ndotësi tjetër që ndikon në cilësinë ose përdorimin specifik të ujit (Neni 5 dhe Aneksi IB, Tabela 2). Për qendrat e populluara me më pak se e.p. 2,000, por të pajisura me një sistem grumbullues, duhet siguruar trajtimi i duhur, p.sh. trajtimi që siguron cilësi të mirë të ujit bujtës (Neni 7);
- Sigurojnë që depozitimi i llumrave nga impjantet e trajtimit të ujërave urbane të ndotura i nënshtrohet rregullave të përgjithshme, regjistrimit ose autorizimit dhe ndalojnë depozitimin e llumit në ujërat sipërfaqësore (Neni 14);
- Sigurojnë kapacitete teknike të përshtatshme (Direktiva Kuadër mbi Ujërat (2000/60/KE) Aneksat II dhe V) për monitorimin e shkarkimeve nga impjantet e trajtimit të ujërave urbanë, dhe monitorimin e ujërave ku shkarkohen ujërat e ndotur të përfshirë në Direktivë (Neni 15 dhe Aneksi ID). Në situata të caktuara, kur legjislacioni është më pak strikt (i çliruar), siç është lejimi për të kryer vetëm trajtimin primar për shkarkimet në zonat më pak sensitive, duhet të ndërmerret një studim i detajuar për të përcaktuar këtë efekt në mjedisin bujtës. (Nenet 6 dhe 8);
- Sigurojnë që autoritetet përkatëse të publikojnë raporte për publikun çdo dy vjet mbi depozitimin e ujërave urbanë të ndotur dhe llumrave në zonat e tyre. (Neni 16 dhe Direktiva Kuadër mbi Ujërat (2000/60/KE) Neni 14). I raportojnë Komisionin mbi:
 - Transpozimin e Direktivës në legjislacionin kombëtar, me tekstet e klauzolave kryesore të ligjit kombëtar të adoptuar në këtë fushë trajtuar nga Direktiva (Neni 19),
 - Zbatimin (Neni 17 dhe Vendimi i Komisionit 93/481/KEE),
 - Raportet mbi situatën e depozimit/asgjесimit të ujërave urbanë të ndotur dhe llumit (Neni 16),
 - Studimin e detajuar të kryer për rastet kur ka shfuqizime të pjesshme të legjislacionit në lidhje me shkarkimet në zonat më pak sensitive (Nenet 6 dhe 8), dhe

- Me kërkesë të Komisionit, raportojnë mbi informacionin e mbledhur përmes monitorimit (Neni 15).

1.4 Kërkesat / Implikimet Indirekte

Kërkesat dhe implikimet indirekte të Direktivës janë:

- Kërkesat e Direktivës mbi Kampionet e Ujit të Pijshëm (79/869/KEE), e cila parashton klauzolat mbi kampionet e ujit të pijshëm, frekuencën e analizës dhe metodat e matjes, për zhvillimin e metodave të matjeve dhe analizave, përcaktimin e pikave të marrjes së kampioneve dhe frekuencën e analizës në lidhje me veçoritë gjeografike dhe kushtet klimaterike, duhet të merren në konsideratë kur të zbatohet Direktiva.
- Kërkesat e Direktivës mbi Nxjerrjen e Ujit të Pijshëm (75/440/KEE), në lidhje me cilësinë e kërkuar për ujërat sipërfaqësorë të destinuar për nxjerrjen e ujit të pijshëm në Shtetet Anëtare dhe Direktivës mbi Ujërat Nëntokësorë (80/68/KEE), mbi mbrojtjen e ujërave nëntokësorë ndaj ndotjes së shkaktuar nga substanca të caktuara të rrezikshme me qëllim që të rritet cilësia e ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, rast për të cilin duhet të përgatitet një plan sistematik që përfshin edhe afatet kohore, do të duhet të zbatohen paralelisht me Direktivën.
- Planet e Administrimit të Zonave Sensitive dhe Programet e Veprimit do të duhet të merren në konsideratë bashkë me Direktivën mbi Nitratet (91/676/KEE) në lidhje me Mbrojtjen e Ujërave ndaj Ndotjes së Shkaktuar nga Nitratet me Origjinë Bujqësore, kur të zbatohet Direktiva.

1.5 Lidhjet me Legjislacione të tjera në Këtë Sektor

Lidhjet me legjislacione të tjera brenda këtij sektori:

- Direktiva Kuadër mbi Ujërat 2000/60/KE. Klauzolat nën Direktivën IUUN formojnë një pjesë integrale të “masave bazë” të programit të masave nën Nenin 11 të DKU kërkuar për çdo Rajon të Basenëve të Lumenjve.
- Direktiva mbi Nitratet (91/676/KEE).
- Direktiva mbi Nxjerrjen e Ujit të Pijshëm (75/440/KEE)
- Direktiva mbi Substancat e Rrezikshme (2006/11/KE) dhe shtatë direktivat e saj bija (Neni 6 është anuluar dhe anulimi ka hyrë në fuqi që nga 22 Dhjetor 2000, dhe pjesa tjetër do të anulohet e do të hyjë në fuqi në 22 Dhjetor 2013) (gjithashtu një listë me substancat përparësore është adoptuar si Aneksi X i Direktivës Kuadër mbi Ujërat (2000/60/KE) me Vendimin 2455/2001/KE).

Lidhjet me legjislacione të tjera brenda sektorëve të tjerë:

Sektori i Mbetjeve:

- Direktiva mbi Fushëgrumbullimet (Landfilllet) (99/31/KE);
- Direktiva mbi Incinerimin e Mbetjeve (2000/76/KE);
- Direktiva mbi Llumrat e Ujërave të Zeza 86/278/KEE.

Rritja e parashikuar në numër dhe efektivitet e impjanteve të TUUN do të rezultojë në një sasi më të madhe llumi ujërash të zeza që do të kërkojë depozitimin ose nëpërmjet përdorimit në bujqësi ose nëpërmjet depozitimit / asgjесimit final në incinerator ose fushëgrumbullim (landfill), dhe rrjedhimisht do të kërkojnë strukturat e duhura.

Sektori PKI:

- Direktiva mbi Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes (PKIN) (2008/1/KE), që mbulon instalime të caktuara industriale të trajtuara nga kjo Direktivë, vendos objektiva më rigorozë dhe përdor, ashtu si edhe Direktiva Kuadër mbi Ujërat (2000/60/KE), një 'përqasje të kombinuar' mbi kontrollin e emetimeve dhe standartet e cilësisë së ujit.

Sektori Horizontal:

- Direktiva Raportuese (91/692/KEE) dhe amendim Vendimi 94/741/KEE në lidhje me pyetësorët për direktiva të caktuara të sektorit të mbetjeve përfshirë llumrat e ujërave të zeza;
- Direktiva mbi Hyrjen në Informacionin Mjedisor (2003/4/KE);
- Direktiva mbi Vlerësimin e Impaktit Mjedisor (85/337/KEE) amenduar nga Direktiva 97/11/KE dhe Direktiva 2003/35/KE.

Sektori i Mbrojtjes së Natyrës

- Direktiva mbi Konservimin e Zogjve të Egër (79/409/KEE) siç është amenduar;
- Direktiva mbi Habitatet (92/43/KEE), siç është amenduar.

Këto Direktiva synojnë në mbrojtjen e habitateve dhe të florës e faunës që ato mbajnë, përfshirë klauzolat specifike për mbrojtjen e zogjve të egër. Cilësia e kënaqshme e ujit është një faktor thelbësor në zona të tilla.

2 Situata Aktuale

2.1 Politika Qeveritare

Strategjia e Sektorit Mjedisor dhe ajo Ndër-Sektoriale (SSMNS), e cila është një pjesë integrale e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), konsiderohet të jetë dokumenti kryesor qeveritar që ravigon politikën shtetërore në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

Qëllimi final i SSMNS është të përmbushë një detyrim kushtetues ndaj qytetarëve të cilët kanë të drejtë të gëzojnë një mjedis ekologjik dhe të shëndetshëm.

Në kontekstin e administrimit të burimeve ujore, SSMNS identifikon si çështjen më kritike aktualisht ndotjen e ujërave sipërfaqësorë që shkaktohet nga shkarkimi i ujërave të ndotur të patrajtuar dhe përcakton qëllimet primare të sektorit në lidhje me këtë çështje.

Objektivat SSMNS dhe treguesit përkatës parashtrohen më poshtë:

Tabela 1: Objektivat SSMNS, treguesit dhe pikësynimet për sektorin e ujërave të ndotur

Zona	Objektivi	Treguesi	Synimi 2009 (%)	Synimi 2014 (%)
Saniteti Urban	Të përmirësohet Saniteti urban	Popullsia e lidhur me rrjetin e kanalizimeve të ujërave të zeza	75	95
Trajtimi i ujërave të përdorur	Të përmirësohet trajtimi i ujërave të ndotur	Popullsia e lidhur me strukturat e trajtimit që plotësojnë standartet bazë të trajtimit sipas Direktivës TUUN	25	50
Saniteti Rural	Të përmirësohet Saniteti rural	Popullsia e lidhur me rrjetin e kanalizimeve të ujërave të zeza ose sistemet septike	55	65

Objektivat e përfshira në SSMNS janë:

- Sisteme efçente dhe të qëndrueshme për administrimin e sektorit të ujërave
- Zbatimi i Projekteve Përparësore për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotur
- Zbatimi i Projekteve Përparësore për administrimin e ujërave të ndotur
- Reduktimi i ndotjes së ujërave sipërfaqësorë në pikën e burimit

- Reduktimi i ndotjes së ujërave sipërfaqësorë në pikën e shpërndarjes
- Përmirësimi i mbrojtjes së ujërave nëntokësorë
- Përmirësimi i monitorimit të ujërave

Strategjia e Shqipërisë për Sektorin e Furnizimit me Ujë dhe Ujëra të Ndotur (SSHSUUN), e elaboruar me mbështetjen e Bankës Botërore në Shtator 2003, është adoptuar nga Qeveria e Shqipërisë.

Fushat më problematike në sektorin e ujësjellësit dhe sanitetit në Shqipëri që kërkojnë reformim janë dokumentuar si më poshtë:

- Administrimi i Kërkesës
- Kuadri Ligjor dhe Institucional
- Qëndrueshmëria financiare e shërbimeve të ujësjellësit dhe subvencionimet qeveritare
- Shërbimi ndaj të varfërve
- Pjesëmarrja e Sektorit Privat
- Monitorimi dhe Pikëreferimi
- Ndërgjegjësimi i publikut dhe programi për komunitetin
- Nevojat për investim
- Kualifikimet e stafit teknik.

SSUN përcakton një reformë afatmesme dhe një program investimi për të stabilizuar dhe përmirësuar shërbimet sanitare dhe ato të ujësjellësit me qëllim që të realizojë shërbime të qëndrueshme sipas standarteve të BE-së në zonat urbane dhe rurale.

Qëllimet afatmesme janë në përputhje me Synimin 17.1 (përgjysmimi i raportit të njerëzve që nuk kanë akses për ujë të pijshëm të sigurt) dhe Synimin 17.2 (sigurimi i aksesit në sanitetin e përmirësuar) e Qëllimeve të Zhvillimit të Mijëvjeçarit.

Aktualisht SSUN po rishikohet dhe përditësohet. Strategjia e rishikuar nuk është adoptuar ende nga Këshilli i Ministrave.

2.2 Rolet & Përgjegjësitë

Më poshtë jepen palët dhe përgjegjësitë e tyre përkatëse në sektorin e ujërave urbanë të ndotur:

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave

MMPAU është përgjegjëse për dhënien e lejeve mjedisore si dhe për monitorimin dhe detyrimin për të vënë në zbatim legjislacionin mjedisor. Brenda Ministrisë, Drejtoria për Kontrollin e Ndotjes është përgjegjëse për kontrollin e ndotjes së ujit.

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

Brenda MPPTT, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve ka disa përgjegjësi në lidhje me sektorin e ujit, veçanërisht me ujësjellës kanalizimet. Drejtoria ka një status të veçantë. Struktura e saj aprovohet nga Këshilli i Ministrave dhe ndërsa raporton te MPPTT, formalisht nuk është pjesë e strukturës së kësaj ministrie. Detyrat e saj kryesore janë të:

- përgatitja e strategji dhe politika për sektorin dhe të ndjekë zbatimin e tyre. Në këtë drejtim, është e rëndësishme të vihet re roli i Drejtorisë së Përgjithshme në ndjekje të zbatimit të 'Strategjisë së Sektorit të

Furnizimit me Ujë dhe Ujërave të Ndotur’ dhe ‘Strategjisë së Furnizimit me Ujë dhe Sanitetit Rural’ të cilat janë adoptuar të dyja në vitin 2003;

- planifikojë buxhetin dhe financimin e sektorit në Shqipëri – nga buxheti i shtetit dhe investitorët e huaj;
- administrojë dhe shpërndajë subvencionime nga shteti;
- monitorojë operacionet dhe funksionimin e Ndërmarrjeve të Ujësjetllës Kanalizimeve;
- nxjerrë udhëzime për investitorët e huaj; dhe
- zbatojë projektet për investime të huaja përmes Njesisë së Zbatimit të Projektit.

Komisioni Rregullator për Ujësjetllësin dhe Sanitetin

Enti Rregullator për Sektorin e Ujit (Enti) u krijua në 1998 sipas Ligjit Nr. 8102 “Mbi Kuadrin Rregullator për Furnizimin me Ujë dhe Administrimin e Ujërave të Ndotur” të datës 28 Mars 1996. Ligji kryesisht rregullon aktivitetin e Entit. Aktivitetet kryesore të Entit janë liçensimi dhe vendosja e tarifave.

Përsa i përket liçensimit, Enti liçenson persona fizikë dhe juridikë që operojnë në sektorin e ujësjetllës kanalizimeve. Megjithëse janë shtetërore, shumica e ndërmarrjeve të ujit kanë aplikuar për liçensa. Duhet theksuar se liçensa të tilla u jepen kompanive për të ofruar shërbime si p.sh ndërmarrjeve të ujësjetllës kanalizimeve dhe jo për të nxjerrë dhe / ose përdorur ujë.

Përsa i përket vendosjes së tarifave Enti ka përgatitur dhe nxjerrë një metodologji në të cilën bazohet vendosja e tarifave. Kjo metodologji është nxjerrë si një rregullore nga Enti i cili autorizohet të veprojë kështu nga Ligji Nr. 8102. Kur një kompani uji dëshiron të ndryshojë (zakonisht të rrisë) tarifat e saj, ndjek këtë procedurë:

- kompania përgatit një paketë dokumentash bazuar tek metodologjia;
- organi përkatës qeveritar vendor (bashkia, komuna) dhe bordi mbikqyrës bashkëngjitin opinionet e tyre në lidhje me ndryshimin e propozuar;
- aplikimi dërgohet tek Enti Rregullator i Sektorit të Ujit;
- Enti kontrollon aplikimin dhe vlerëson arsyeshmërinë e aplikimit si edhe nëse kompania e ujit po bën progres përsa i përket treguesve të performancës standarte siç janë uji i pafaturuar, norma e arkëtimeve nga faturat, etj.;
- Enti mund të aprovojë aplikimin, ta refuzojë atë ose të sugjerojë një ndryshim të modifikuar. Ai përgatit një justifikim të arsyeshëm për vendimin e tij ndaj të cilit nuk mund të apelohe.

Enti duhet të luajë qartësisht një rol në lidhje me zbatimin e Direktivës mbi Ujërat Urbane të Ndotur dhe në vecanti në lidhje me inkurajimin e vendosjes së tarifave adekuate (të përshtatshme) për të mbuluar të paktën kostot operative dhe ato të mirëmbajtjes.

Kompetencat Vendore

Këshilli i Qarqeve

Ka 12 Këshilla Qarqesh, një për çdo rajon (Qark). Çdo Këshill Qarku përbëhet nga zyrtarë të zgjedhur që përfaqësojnë komunat dhe bashkitë me lidhje ekonomike, gjeografike, tradicionale dhe interesa të

përbashkëta. Këshillat e Qarqeve luajnë një rol të rëndësishëm në planifikimin e përdorimit të tokës dhe parashikohet se në të ardhmen do të luajnë një rol formal në planifikimin mjedisor gjithashtu.

Çdo Qark ka gjithashtu një Prefekt, i cili propozohet nga Ministria e Brendshme dhe emërohet nga Kryeministri. Prefekti vepron si një hallkë midis qeverisë qendrore dhe qarqeve dhe mbështetet nga administrata. Prefekti më tepër luan një rol koordinues se sa rol rregullator.

Bashkitë dhe komunat

Kërkohej që strukturat e qeverisjes vendore duhet të përmbushin detyrime të përbashkëta përsa i përket mbrojtjes së mjedisit dhe zbatimit të ligjit mbi mjedisin.

Ligji kryesor në lidhje me qeverisjen vendore është Ligji Nr. 8652 “Mbi Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore” i datës 31 Korrik 2000. ‘Mbrojtja Mjedisore’ përshkruhet si një funksion i pushtetit vendor që ‘ndahej’ me pushtetin qendror. Kjo nënkupton që pushteti qendror duhet t’i sigurojë mbështetje financiare pushtetit vendor në atë masë që pushteti qendror kërkon që pushteti lokal të kryejë një funksion të ndarë me të ose të plotësojë një standart kombëtar në kryerje të këtij funksioni.

Për më tepër komunat dhe bashkitë kanë marrë përgjegjësi për administrimin e ujësjellësit dhe grumbullimin e ujërave të ndotur që nga fillimi i vitit 2001.

Kompanitë lokale të ujësjellës kanalizimeve

Para vitit 2000 të gjitha kompanitë e ujësjellës kanalizimeve ishin ndërmarrje shtetërore. Në vitin 2000 ato u shndërruan në kompani tregtare aksionere. Megjithatë, ndërsa statusi i tyre ligjor ka ndryshuar, shteti ka mbetur aksioneri i tyre i vetëm.

Për më tepër procesi i transformimit ligjor nuk ka përfunduar ende. Si pjesë e politikës së decentralizimit, asetet e mbajtura nga pushteti qendror në shumicën e rasteve janë transferuar te organet e pushtetit vendor të cilat do të bëhen aksioneret e vetme të këtyre kompanive.

Megjithëse pronësia e kompanive të shërbimeve të ujit ka kaluar tek bashkitë, këto të fundit nuk janë ende financiarisht përgjegjëse për to. Për momentin, MPPTT ende paguan subvencionime operationale kur është e nevojshme.

Kuptohet që procesi i transferimit të pronësisë, është më kompleks në ato raste kur një kompani i shërben më shumë se një komune ose bashkie. Kompania e ujësjellësit në Durrës për shembull, furnizon tre bashki dhe tetë komuna. Në këto raste transferimet do të bëhen tek një ‘autoritet me pushtet të përbashkët’.

Bordet mbikqyrëse të kompanive të transferuara të ‘decentralizuara’ do të modifikohen megjithëse parashikohet që MPPTT do të ketë një person të

emëruar në mënyrë që të mbajë lidhjen me pushtetin qendror. Për sa i përket të ardhmes së këtyre kompanive tashmë po konsiderohen variante të ndryshme që i hapin rrugë përfshirjes së sektorit privat siç janë kontratat e administrimit. Për shkak se shumë kompani uji janë tepër të vogla, po parashikohet një përqsasje rajonale (në rang qarku) ku disa kompani do të 'paktohen' së bashku për sa i përket administrimit. Me fjalë të tjera asetet do të mbeten të ndara.

2.3 Kuadri Ligjor Aktual

Neni 28 i Ligjit Nr. 8093 mbi "Burimet Ujore" përcakton bazën ligjore të kuadrit rregullator për ujërat e zeza. Kuadri i përgjithshëm për Direktivën e TUUN mund të gjendet në Ligjin Nr. 9115 mbi "Trajtimin Mjedisor të Ujërave të Ndotura" ("Ligji mbi Ndotjen e Ujit - LNU"); dhe më shumë detaje mund të gjenden në Dekretin e Këshillit të Ministrave (DKM) Nr. 177 mbi Normat e Lejuara të Shkarkimeve dhe Kriteret Zonale të Mjediseve Ujë Marrës.

Duhet venë në dukje gjithashtu se është përgatitur³ një projekt Ligj mbi Burimet Ujore, i cili mbështet një përqsasje më të integruar në administrimin e mbetjeve.

2.4 Statusi Aktul i Zbatimit – Analiza e Boshllëqeve Ligjore

Ndërsa Ligji mbi Ndotjen e Ujit transpozon një numër përkufizimesh nga Direktiva, një pjesë e tyre mungojnë ose janë transpozuar pjesërisht; përfshirë 'ujërat urbanë të ndotur', 'sistemin grumbullues', 'trajtimin primar' dhe trajtimin sekondar'. Përkufizimi i '1 e.p.' është në konflikt me përkufizimin e Direktivës.

Detyrimi për të siguruar sisteme grumbulluese për të gjithë aglomeratet prej 2,000 e.p. ose më shumë (Neni 3.1) mungon; megjithëse kërkesat teknike për çdo sistem grumbullues (Neni 3.2) janë transpozuar me VKM-në 177/2005.

Ndërsa UUN nga aglomeratet me e.p ndërmjet 2,000 dhe 10,000 duhet t'i nënshtrohen trajtimit sekondar para shkarkimit të tyre tek ujërat e ëmbra ose ato estuare (grykajat e lumenjve); pjesa tjetër e klauzoleve të Nenit 4.1 nuk është transpozuar. Përrjashtimi diskrecional për rajonet me male të larta (Neni 4.2) është transpozuar siç duhet, ashtu si edhe kërkesat teknike për ITUUN (Neni 4.3). Megjithatë, mungon metoda e llogaritjes së ngarkesës e.p.

Baza ligjore për identifikimin e zonave sensitive është transpozuar. (Neni 5.1) (megjithëse, kuptohet që nuk është shpallur ende asnjë zonë sensitive). Klauzolat substanciale të pjesës tjetër të Nenit 5 janë transpozuar.

Klauzolat e Nenit 6 të cilat lejojnë / marrin në konsideratë trajtimin më pak rigoroz për shkarkimet në zona më pak sensitive në tërësi janë transpozuar plotësisht. Klauzolat e Nenit 7 të cilat marrin në konsideratë që disa

³ Ky projekt ligj u përgatit nga projekti LMP

shkarkime të caktuara t'i nënshtrohen trajtimit të përshtatshëm, janë transpozuar.

Klauzolat trans-kufitare të Nenit 9 mungojnë. Kërkesat e performancës së ITUUN (Neni 10) korrespondojnë pjesërisht.

Megjithëse një regjim i caktuar lejues është krijuar për UN industriale që shkarkohen në sistemet grumbulluese sipas Ligjit mbi Ndotjen e Ujit, klauzolat e VKM-së 177/2005 nuk janë aspak të qarta. Kërkesat e regjimit lejues (Neni 11.2 dhe 11.3) mungojnë. Megjithatë, kërkohen leje për shkarkimet nga ITUUN (Neni 12). Klauzolat e Nenit 13 (UN industriale të biodegradueshëm) dhe Neni 14 (depozitimi / asgjësimi i llumrave të ujërave të zeza) mungojnë. Në legjislacion është përcaktuar një sistem i caktuar monitorues, megjithatë ky sistem nuk kryen monitorimin e llumit nga ujërat e zeza. (Neni 15.3). Nuk ekziston asnjë detyrim ligjor në lidhje me publikimin e raporteve situacionale çdo dy vjet (Neni 16).

Aneksi I Pjesët A dhe B janë transpozuar në mënyrë korrekte, kurset pjesët C dhe D mungojnë. Aneksi II është transpozuar në mënyrë korrekte. Aneksi III nuk është transpozuar.

2.5 Gjendja Aktuale e Investimeve

Në Tetor 2008 u është dërguar një pyetësor bashkive, komunave dhe kompanive të ujësjellës / kanalizimeve. Qëllimi i pyetësorëve ishte të merreshin të dhëna mbi gjendjen ekzistuese të furnizimit me ujë të publikut, grumbullimit të ujërave të ndotur dhe impjanteve publike të trajtimit. Rezultatet e përgjigjeve të marra nga pyetësori përshkruhen në Aneksin II. Gjithashtu, Aneksi II liston disa të dhëna mbi investimet në vijueshmëri në sektorët e ujit dhe ujërave të ndotur në bashki dhe komuna [Reforma në Sektorin e Ujësjellës Kanalizimeve].

2.5.1 Ujësjellësi Publik (Furnizimi me ujë)

Këtu është me vend të diskutohet për gjendjen e ujësjellësit publik, pasi sikur të mos ekzistonte asnjë sistem ujësjellësi publik në qytet, atëherë nuk do të kishte shumë hapësirë për ujërat e zeza. Kur bëhen planet për admininstrimin e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura bashkiake, në fakt përparësi i duhet dhënë optimizimit të ujësjellësit publik dhe ndërtimi i rrjeteve të ujërave të zeza duhet të kombinohet me përmirësimin e rrjeteve të ujësjellësit.

Në vitin 2001, sipas të dhënave statistikore zyrtare, nga 727,715 shtëpi gjithsej (Census 2001), 549,338 shtëpi janë furnizuar me ujë nga sistemet e ujësjellësit publik, gjë që nënkupton një shërbim në nivelin 75%. Vetëm një pjesë e shtëpive që furnizohen me ujë kanë lidhje brenda në shtëpi me sistemin e ujësjellësit, në vitin 2001 kjo shifër ishte në nivelin 62%. Në vitin 2001, 92,847 shtëpi furnizoheshin me ujë nëpërmjet sistemeve të tyre dhe 85,530 shtëpi nuk kishin asnjë lloj furnizimi me ujë në banesat e tyre [Census 2001].

Shumica e sistemeve të ujësjellësit publik janë të vjetra dhe të prishura, me infrastrukturë të shkatërruar dhe shfrytëzim e mirëmbajtje të keqe. Nevojat për investim në sektorin e ujit dhe sanitetit kapin shifrën prej 170 milionë USD në vit, kurse investimet aktuale janë të barasvlefshme me 10-30 milionë USD në vit [Banka Botërore, Korrik 2002]. Në përgjithësi sistemet e ujësjellësit publik nuk funksionojnë në mënyrë të kënaqshme. Rrallë kryhet furnizimi i vazhdueshëm i popullsisë me ujë me cilësi të sigurt. Në përgjithësi sistemet karakterizohen nga:

- Gjendje e dobët e impjanteve të prodhimit të ujit dhe mirëmbajtjes së tyre.
- Kapacitet i pamjaftueshëm për transportin dhe shpërndarjen e ujit
- Nivele të larta të ujit të pamatur (pafaturuar), për shkak të humbjeve të ujit, dhe
- Rreziqeve të kontaminimit të ujit si pasojë e rrjedhjeve / derdhjeve të ndotësve në sistemet e shpërndarjes.

Sistemet e ujësjellësve publikë administrohen dhe shfrytëzohen nga 56 kompani aksionere për shërbimet e ujësjellës kanalizimeve dhe një numër ndërmarrjesh komunale për ujin. Aktualisht po bëhet reformimi i strukturës organizative për shërbimet e ujësjellësit publik.

Aktualisht 55 Kompani Ujësjellës Kanalizimesh (UK Sh.A.) ofrojnë shërbime publike për furnizimin me ujë dhe kanalizimet në Shqipëri. Të dhënat për bashkitë dhe komunat të cilat marrin shërbime nga Kompanitë e Ujësjellës Kanalizimeve janë dhënë në Aneksin III. Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve disponon një bazë të dhënash me shumë të dhëna dhe indikatorë të lidhur me performancën dhe parametrat financiarë të kompanive sipas vitit kalendarik. Baza e të dhënave përdoret për të vlerësuar performancën e kompanive dhe për të caktuar pikat e referimit. Është pjesë e të dhënave që përdoren nga Enti Rregullator i Sektorit të Ujit për të vendosur nëse të aprovojë ose jo një aplikim për ndryshim në tarifa dhe për të negociuar midis MPPTT dhe kompanive në lidhje me subvencionimet operative. Treguesit e marrë nga baza e të dhënave mund të përdoren gjithashtu në kontratat e shërbimeve të lidhura ndërmjet kompanive dhe bordeve të tyre mbikqyrëse ose në kontratat e Ekzekutivit të kompanive të ujit.

Disa të dhëna për vitin 2008 mbi mbulimin me ujë dhe sanitetin në Shqipëri janë paraqitur në Tabelën 2a. Brenda zonave të shërbimit të Kompanive të Ujësjellës Kanalizimeve jetojnë rreth 3.2 milionë njerëz, afërsisht 86% e popullsisë totale të Shqipërisë.

Të dhënat në Tabelën 2a tregojnë se rreth 2.5 milionë njerëzve u ofrohet shërbim nga ujësjellësi publik (78% e popullsisë), dhe se afërsisht 1.5 milionë njerëz janë të lidhur me sistemet e kanalizimeve (46% e popullsisë).

Një sërë treguesish financiarë agregatë dhe tregues të tjerë të performancës janë paraqitur në tabelën 2b. Këto janë të dhëna mesatare për të gjitha kompanitë e ujit.

Disa pika shumë të rëndësishme janë:

- mesataret nga uji pa të ardhura (që nuk faturohet) 72%
- përqindja e lidhjeve të matura / faturuara = 41%

- norma e vjeljes së të arkëtueshmeve nga shtëpitë = 73%
- shitjet mesatare të ujit tek shtëpitë (që janë të lidhura) = 93.5 l/person/ditë
- disponueshmëria (koha që ka ujë në shtëpi) mesatare e ujit = 13 orë/ditë

Tabela 2: Të dhëna mbi shërbimet e ujësjellës kanalizimeve ofruar nga Kompanitë e Ujësjellës Kanalizimeve [Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit], (shih gjithashtu Aneksin III)

Ndërmarrja e Ujit	Popullsia			Nr. i njerëzve që furnizohen nga ujësjellësi publik			Nr. i njerëzve të lidhur me kanalizimet		
	Total	Urbane	Rurale	Total	Urban	Rural	Total	Urban	Rural
Pukë UK Sh.A	7369	4369	3000	2773	2148	625	1563	1500	63
Sarandë UK Sh.A	44201	38654	5547	38791	34548	4243	34206	33088	1141
Vau Dejës U Sh.A	12438	5490	6948	3111	3111	0	0	0	0
Tropojë U Sh.A	12306	9141	3164	12302	9138	3164	0	0	0
Krujë UK Sh.A	15908	15449	459	15665	15360	305	10530	10530	0
Berat UK Sh.A	71967	64204	7763	65722	60722	5000	62058	60722	1336
Lezhë UK Sh.A	36225	34625	1600	27664	26064	1600	27664	26064	1600
Pogradec UK Sh.A	55004	39849	15155	55005	39850	15155	37755	37755	0
Korçë UK Sh.A	85875	84375	1500	66500	65000	1500	62432	62432	0
Elbër UK sh.p k	116500	109500	7000	116000	109500	6500	101000	101000	0
Shkodër UK Sh.A	92500	92500	0	85000	85000	0	65000	65000	0
Përmet U Sh.A	11525	10875	650	11525	10875	650	0	0	0
Vlorë U Sh.A	146671	136292	10379	132526	124146	8380	0	0	0
Durrës UK Sh.A	357958	222703	135255	207336	142317	65019	142094	142094	0
Tiranë UK Sh.A	938350	700000	238350	846700	700000	146700	647500	647500	0
Novoselë U Sh.A	19030	0	19030	9002	0	9002	0	0	0
Shkodër (F) U Sh.A	43108	0	43108	8508	0	8508	0	0	0
Elbasan (F) U Sh.A	107754	16915	90839	64776	16273	48503	0	0	0
Korçë (F) U Sh.A	39138	5000	34138	20110	4412	15698	0	0	0
Lushnjë (F) U Sh.A	55000	0	55000	23459	0	23459	0	0	0
Gjirokastër (F) U Sh.A	4283	0	4283	4283	0	4283	0	0	0
Rubik UK Sh.A	2973	2719	254	1852	1779	74	1723	1446	277
Bilisht U Sh.A	9709	9709	0	6561	6561	0	0	0	0
Mirditë UK Sh.A	9089	8276	813	6074	5261	813	5261	5261	0
Fushë Arrëz UK Sh.A	5419	4503	916	1767	1767	0	1667	1667	0
Rrogozhinë UK Sh.A	21626	11180	10447	11979	6065	5914	3281	2465	819

Fier UK Sh.A	127088	81750	45338	123538	81500	42038	71125	69825	1300
Librazhd UK Sh.A	19014	16276	2738	17940	15445	2495	15420	15420	0
Fushë-Krujë UK Sh.A	22900	11300	11600	9385	8375	1010	8360	8360	0
Kavajë UK Sh.A	92049	38317	53732	56989	29111	27877	20906	20906	0
Mallakastër UK Sh.A	29176	12050	17126	18787	10542	8245	10500	10500	0
Gjirokastër (Q) UK Sh.A	34162	34162	0	28468	28468	0	19151	19151	0
UK Lushnjë (Q) Sh.A.	63000	55000	8000	41000	38000	3000	30000	30000	0
Libohovë UK Sh.A.	4104	3720	384	3082	2780	302	563	563	0
Selenicë UK Sh.A	8300	8300	0	6725	6725	0	0	0	0
Peqin UK Sh.A	11549	8939	2610	7725	6975	750	0	0	0
Peshkopi U Sh.A	30000	13000	17000	30000	13000	17000	0	0	0
Gramsh U Sh.A	21703	14812	6892	21703	14812	6892	0	0	0
Kuçovë UK Sh.A	46068	30198	15870	36091	27704	8388	24340	23018	1322
Burrel UK Sh.A	22260	18200	4060	22260	18200	4060	15162	15162	0
Bulqizë U Sh.A	15518	9631	5887	12257	9632	2626	0	0	0
Tepelenë U Sh.A	18825	16200	2625	9750	8500	1250	0	0	0
Polican U Sh.A	10200	9200	1000	10200	9200	1000	0	0	0
Ersekë UK Sh.A	5900	5900	0	5900	5900	0	5850	5850	0
Has U Sh.A	5600	3600	2000	5000	3000	2000	0	0	0
Çorovodë U Sh.A	6103	5906	197	4133	3965	168	0	0	0
Malësi e Madhe U Sh.A	52000	12000	40000	33850	10500	23350	0	0	0
Kukës U Sh.A	40000	25000	15000	40000	25000	15000	16667	16667	0
Kurbin U Sh.A	65068	41442	23626	41416	39294	2122	0	0	0
Delvinë U Sh.A	9600	9600	0	5700	5700	0	0	0	0
Divjakë Sh.A U.	13227	0	13227	13227	0	13227	0	0	0
Ura-Vajgurore U Sh.A	14205	8203	6002	9195	4582	4613	0	0	0
Krastë UK Sh.A.	3968	2438	1530	2738	2438	300	2450	2450	0
Patos U Sh.A	34754	23471	11283	16705	12460	4245	0	0	0
Kamëz Sh.a. UK	85831	31911	53920	32948	6658	26290	16805	6658	10170
TOTALI	3234095	2176853	1057242	2511702	1918360	593342	1461029	1443052	18026

Gjithashtu, është projektuar një impjant kërkimor demonstrativ për TUU i cili vë në shfrytëzim ligatinën artificiale dhe teknologjitë e ripërdorimit dhe është propozuar që ky impjant të ndërtohet në fshatin e fëmijëve SOS në periferi të Tiranës së Madhe. Instalimi do të ketë një kapacitet prej 250 e.p., dhe ka për qëllim të demonstrojë një teknologji me kosto të ulët dhe miqësisht ekologjike e cila do të ishte e përshtatshme për komunitetet e izoluar me popullsi prej 2000 deri në 4000 banorë.

Tabela 2b: Treguesit financiarë kryesorë për Ujin dhe Sanitetin në Shqipëri për vitin 2008

Burimi: Baza e të dhënave të referencës së DPUK.

Treguesit	Njësia	2008
Personeli /lidhje	Personeli /1000 lidhje	6.1
Mbulimi i furnizimit me ujë	%	77.8
Mbulimi i rrjetit të kanalizimeve	%	45.2
Prodhimi i ujit	l/person/d	333.2
Konsumi i Energjisë (kwh/m3)	kwh/m3	1.43
Sasia totale e ujit të shitur	l/person/d	93.5
Sasia e ujit shitur familjeve	l/person/d	74.2
Uji pa të ardhura (i pafaturuar)	%	71.9
% e lidhjeve me sahat matës	%	41.3
% e sasisë së ujit të shitur të faturuar / matur	%	39.9
Kosto operative direkte/sasinë në m3 të ujit të prodhuar	Lekë/m3	13.3
Kosto operative direkte/sasinë në m3 të ujit të shitur	Lekë/m3	47.3
% e kostos së punës/kostot totale operative direkte	%	39.8
% e kostos së energjisë/kostot totale operative direkte	%	38.5
Çmimi mesatar i Ujësjetës	Lekë/m3	40.9
Çmimi mesatar i Ujit	Lekë/m3	36.7
Diferenca midis kostos dhe çmimit mesatar	Lekë/m3	-25.5
Kostot totale operative/ sasinë në m3 të ujit të prodhuar	Lekë/m3	17.5
Kostot totale operative/ sasinë në m3 të ujit të shitur	Lekë/m3	62.2
Norma e faturave të paguara (në përgjithësi)	%	78.5
Norma e faturave të paguara (familjet)	%	72.7
Norma e faturave të paguara (njësitë private)	%	74.4
Norma e faturave të paguara (njësitë publike)	%	103.4
% e kostove operative direkte mbuluar nga të ardhurat	%	79.8
% e kostove operative direkte mbuluar nga faturat e paguara	%	66.6
% e kostove operative direkte mbuluar nga subvencionimet	%	32.3
% e kostove operative totale mbuluar nga të ardhurat	%	60.4
% e kostove operative totale mbuluar nga faturat e paguara	%	50.4
% e kostove operative totale mbuluar nga subvencionimet	%	24.4
Vazhdimësia (koha) e furnizimit me ujë	Orë /ditë	13.3

2.5.2 Kanalizimet dhe trajtimi i ujërave të ndotur

Në tabelën e mësipërme janë paraqitur të dhënat mbi shërbimet e kanalizimeve urbane. Pak informacion është i disponueshëm për sa i përket gjendjes së sistemeve të kanalizimeve. Në disa qytete sistemet janë të vjetra dhe në një gjendje të keqe për t'u riparuar. Gjithashtu ekzistojnë edhe disa sisteme që nuk janë fare në përdorim.

Pjesa më e madhe e ujërave urbanë të ndotur shkarkohet pa u trajtuar. Probleme serioze të ndotjes së ujit janë shkaktuar në lumin e Ishmit, në rrjedhën e poshtme të Tiranës, dhe në lumin e Semanit pranë Fierit për shkak të ndotjes nga puset e naftës. Problemet e ndotjes së ujit në lumenjtë Mat dhe Shkumbin janë shkaktuar kryesisht nga punimet në miniera.

Të dhënat mbi impjantet e trajtimit të ujit të ndotur janë si më poshtë:

Kavajë	ITUN në punë
Vlorë	ITUN ka përfunduar ndërtimi, por nuk është vënë në punë ende
Pogradec	ITUN ka përfunduar ndërtimi, pritet të fillojë puna këtë vit (2009)
Durrës	ITUN në ndërtim e sipër
Lezhë	ITUN ndërtimi nuk ka filluar akoma
Sarandë	ITUN ndërtimi nuk ka filluar akoma
Korçë	ITUN në ndërtim e sipër
Shkodër	ITUN ndërtimi në fazën e parë
Shirokë	ITUN planifikuar (në Bashkinë e Shkodrës)
Velipojë	ITUN planifikuar
Tiranë	ITUN planifikuar

2.5.3 Planet në vijim për administrimin e ujërave urbanë të ndotur

Në Tiranë, është në vijim e sipër një projekt për përmirësimin e grumbullimit të ujërave të ndotur dhe strukturave të trajtimit të tyre. Qeveria Japoneze e ka financuar projektin nëpërmjet një kredie të butë me vlerë prej 100,000,000. USD. Projekti synon të sigurojë grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotur në Qytetin e Tiranës, Kamëz dhe Kashar. Projekti parashikon/ sjell ndërtimin e një kolektori të ri dhe Fazën I të një impjanti për trajtimin e ujërave të ndotur me një kapacitet prej 1,000,000 EP. Mbetjet e lëngëta nga impjanti do të shkarkohen në lumin e Lanës (shih Aneksin III).

Është në vijim e sipër një projekt i financuar nga KfW për rindërtimin e sistemeve të ujit dhe ujit të ndotur (me vlerë prej € 130,000,000) në Kukës, Has, Krujë, Kavajë, Korçë, Elbasan, Berat, Kuçovë, Lushnjë.

Në vitin 2008 investimet e kryera në sektorin e ujësjellës kanalizimeve kapën shifrën prej rreth 5 miliardë lekë (rreth € 39 milionë). Në periudhën 2000-2008 investimet totale në këtë sektor arritën në afërsisht 50 miliardë lekë (rreth € 390 milionë).

2.5.4 Administrimi i ujërave industriale të ndotur

Është e disponueshme një bazë të dhënash (Regjistri i Agroindustrisë) me të dhënat nga industritë agro - ushqimore. Baza e të dhënave përmban të dhëna nga industritë në tetë prefektura. Jepen të dhënat për produktet, kapacitetet prodhuese dhe numrin e punëtorëve. Industritë më të mëdha në

Tiranë janë: Birra Tirana (150 punëtorë) me një ngarkesë uji të ndotur të përlogaritur prej 5000 EP, KMY përpunim mishi (173 punëtorë) dhe Coca Cola pije freskuese (170 punëtorë). Birra Korça ka të ngjarë të ketë një ngarkesë uji të ndotur prej 5000 e.p. në bazë të rendimentetit të prodhimit prej 40000 litra birrë në ditë.

Në tabelën 3 është dhënë një pasqyrë e industrive më të mëdha të përzgjedhura në bazë të numrit të personelit si kriter për ngarkesat potenciale të ujit të ndotur. Ngarkesat e ujit të ndotur të këtyre industrive janë më të vogla se 4000 e.p., megjithëse nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të llogaritur me saktësi ngarkesat e ujit të ndotur.

Tabela 3: Të dhënat për industritë agro-ushqimore

Prefektura	Kompania	Produktet	Qyteti	Numri i Personelit
Fier	SHA Vajra Bimore	Vaj i rafinuar	Fier	32
	Mulliri i Artë	Miell	Vajkan	20
	Basha	Bukë	Fier	48
	Lufra	Bulmet	Kolonjë	20
Gjirokastrë	Fresh Kompany	Pije freskuese	Frashtan	41
	Alfa Glina Sh. A.	Pije freskuese, ujë	Glinë	83
	Inter Balkanik	Lëngje frutash	Libohovë	38
	EPS-1	Kroasantë	Gjirokastrë	68
Korçë	Firma Rilindja	Pije alkoolike	Korçë	21
	Firma Fix	Mish	Korçë	20
	Birra Korca	Birrë	Korçë	
	Atlas-1	Pije Alkoolike	Maliq	20
Shkodër	Joy Fllorinas	Pije freskuese	Çiflig	20
	Mark Babani	Peshk	Laç	50
	Univers Figo	Mish	Shkodër	40
Tiranë	Kimça	Mish	Shkodër	46
	Tirana	Birrë	Tiranë	150
	Coca Cola	Pije freskuese	Tiranë	170
	Ferlat	Bulmet	Rrogozhinë	35
	Extra Milk	Bulmet	Tiranë	30
	Sh.A. Miell	Miell	Tiranë	45
	Sh.A. Bloje	Miell	Tiranë	65
	Derbi	Pije freskuese	Tiranë	70
	Kenedy Alb	Mish	Tiranë	20
	Bardhi	Mish	Tiranë	30
	HAKO	Mish	Tiranë	35
	KMY	Mish	Yzberisht	173
	EHW	Mish	Kashar	85
	Aquila Liquori	Pije alkoolike	Tiranë	67

	SHA	Bukë	Tiranë	65
Vlorë	Birra Norga	Birrë	Vlorë	75
	ALSA	Mish	Vlorë	27

3 Plani i Përafrimit

3.1 Plani i Përgjithshëm dhe Afatet e Realizimit të Objektivave

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit më 12 Prill 2006 (MSA) me Komunitetin Europian dhe Shtetet e tij Anëtare, Shqipëria ka konfirmuar fuqimisht angazhimin e saj politik, tashmë të shprehur qartë, për t'u anëtarësuar në BE.

Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA 2007 - 2012, i aprovuar nga Këshilli i Ministrave më 5 Korrik 2006, në një farë mase tregon një konfirmim të dedikimit të të gjitha institucioneve përkatëse dhe punonjësve civilë për t'iu përgjigjur kërkesave të procesit të integritimit në BE.

Një nga kushtet kryesore për anëtarësi në BE është integrimi dhe zbatimi i legjislacionit të BE-së, i ashtuquajtur procesi i përafrimit, i cili konsiston në tre komponentë kryesorë: transpozimin ligjor, zbatimin praktik dhe detyrimin për ta zbatuar.

Plani i përgjithshëm për të arritur përafrimin e plotë prezantohet në paragrafët vijues. Ky plan përbëhet nga plani i transpozimit ligjor dhe plani i zbatimit (përfshirë edhe detyrimin për zbatim).

Plani i transpozimit ligjor konsiston në hartimin e nje VKM-je e cila do të anullojë dhe zëvendësojë VKM-në ekzistuese 177/2005. Arsyetimi përkatës diskutohet më poshtë në detaje.

Plani i zbatimit përbëhet nga një sërë veprimesh / masash të cilat janë konsoliduar në 5 grupe madhore të veprimeve të zbatimit (referojuni tabelës më poshtë). Një përshkrim i detajuar i planit të zbatimit është paraqitur në paragrafin 3.4.

Në specifikimin e shpërndarjes / fazimit në kohë të këtyre veprimeve, përjasja e ndjekur ka qenë që të specifikojë vitet relative (duke filluar nga viti 0). Në praktikë ritmi me të cilin kjo direktivë mund të transpozohet dhe zbatohet do të varet nga disponueshmëria e burimeve të rralla të fuqisë punëtore dhe buxhetet që duhen ndarë me sektorët e tjerë. Për këtë arsye, do të ishte e mundur të caktohej një afat kohor i saktë vetëm kur të dihet data e pranimit në BE dhe kur kërkesat për burime për të gjitha direktivat përparësore të vendosen krah për krah dhe të krahasohen me burimet e pritura të disponueshme.

Një plan paraprak investimi për infrastrukturën e grumbullimit dhe trajtimit të ujërave urbanë të ndotur është hartuar dhe paraqitur në këtë raport. Ky plan shërben si hapi i parë drejt formulimit të Planit Kombëtar për Administrimin e Ujërave të Ndotur.

Qëllimi final i këtij plani është respektimi i kërkesave të Direktivës së BE-së mbi Trajtimin e Ujërave Urbane të Ndotura. Plani do të zbatohet brenda strukturës së ardhshme të përgjithshme për administrimin e ujit dhe ujërave të ndotur në Shqipëri. Si i tillë, plani lidhet ngushtësisht me zbatimin e Direktivës Kuadër mbi Ujin dhe legjislacionet e tjera që kanë të bëjnë me burimet ujore dhe administrimin mjedisor. Është parashikuar që plani mund të ekzekutohet në një periudhë kohore prej 15 deri 20 vjetësh.

Plani për zbatimin e Direktivës mbi Trajtimin e Ujërave Urbanë të Ndotur do të zhvillohet në këto hapa kryesore si më poshtë vijon:

1. Formulimi dhe pranimi i planit final, përfshirë vlerësimin strategjik mjedisor dhe analizën ekonomiko-financiare;
2. Krijimi i një strukture organizative për zbatimin e planit;
3. Zbatimi i Planit nëpërmjet etapave kryesore të mëposhtme:
 - Studime fizibiliteti dhe vlerësimi i impaktit mjedisor
 - Projektimi dhe tenderimi
 - Ndërtimi dhe sigurimi i cilësisë / standarteve të ndërtimit.

Afatet e realizimit të objektivave të planit të përgjithshëm për përafrimin e plotë janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

Tabela 4: Afatet e realizimit të objektivave të planit të përgjithshëm të përafrimit

Plani i Përgjithshëm i Përafrimit	Fillon (muaj/vit)	Mbaron (muaj/vit)
<i>Transpozimi Ligjor</i>	01/0000	06/0000
<i>Zbatimi dhe detyrimi për zbatim</i>	07/0000	12/0018
o Forcimi institucional dhe ngritja e kapaciteteve	07/0000	12/0002
o Puna përgatitore	07/0000	12/0010
o Grumbullimi dhe trajtimi i ujërave të ndotur	01/0001	12/0018
o Depozitimi i llumit dhe ujërave të ndotur të trajtuar	01/0003	12/0018
o Monitorimi, mbajtja e të dhënave dhe raportimi	01/0002	12/0004

3.2 Plani i Transpozimit

Plani i transpozimit ka si pikënisje projekt ligjin mbi Burimet Ujore përgatitur nga projekti LMPSH. Ky projekt ligj do të anulohet Ligjin mbi Ndotjen e Ujit (shih pjesën 4.3 të PZDS – të Direktivës Kuadër mbi Ujin për më shumë informacion). VKM-ja Nr. 177/2005 mbi Normat e Lejuara të Shkarkimeve dhe Kriteret Zonale të Mjediseve Ujë Marrëse gjithashtu, do të duhet të anulohet dhe një VKM e re e cila transponon plotësisht kërkesat e Direktivës

mbi ITUUN do të duhet të adoptohet. Do të duhet të tregohet kujdes për t'u siguruar që çdo kërkesë lejuese të jetë në përputhje me projekt ligjin e ri mbi Ndotjen Mjedisore dhe Projekt ligjin mbi Lejueshmërinë, të cilët janë duke u përgatitur nga projekti aktual.

Amendimi / hartimi i një ligji të ri mbi Burimet Ujore konsiderohet tashmë si pjesë e planit të transpozimit për Direktivën Kuadër të Ujit prandaj nuk përfshihet këtu.

Për këtë arsye plani i transpozimit ligjor thjesht do të hartojë një VKM të re që do të transpozojë plotësisht Direktivën mbi ITUUN dhe do të anultojë VKM-në 177/2005.

3.3 Plani i Zbatimit

Gjetjet kryesore të analizës së boshllëqeve kanë krijuar bazat për identifikimin dhe përcaktimin e veprimeve të duhura të ardhshme në lidhje me zbatimin dhe detyrimin për zbatim. Këto veprime do të mundësojnë zbatimin e plotë dhe do të detyrojnë zbatimin e kësaj Direktive, prandaj janë esenca e Planit të Zbatimit.

Veprimet e nevojshme për të siguruar zbatimin e plotë dhe për të detyruar zbatimin e kësaj Direktive janë paraqitur më poshtë bashkë me një përkthim të shkurtër për secilin veprim të propozuar, institucionin përkatës dhe periudhën e propozuar për zbatim.

Table 5: Veprimet për zbatimin dhe detyrimin për zbatim

Kërkesa e BE-së (Nenet)	Veprimet	Institucioni Përgjegjës	Periudha e zbatimit (muaj/vit)
Neni 17	1. Krijimi i Autoriteteve Kompetente (AK) në nivel kombëtar	Qeveria	07/0000 – 12/0002
Aneksi II Nenet 5 dhe 6 dhe Aneksi IV	2. Identifikimi i zonave Sensitive dhe Aglomerateve	MMPAU	07/0000 – 12/0001
-	3. Projekti mbi aspektet financiare të zbatimit të DUUP	MMPAU	07/0001 – 12/0003
-	4. Sigurimi dhe trajnimi i burimeve njerëzore në Bashki	Bashkitë	01/0002 – 12/0016
-	5. Ngritja e infrastrukturës (ndërtimi i rrjeteve të ujërave urbanë të ndotur dhe impjanteve të trajtimit të tyre)	Bashkitë	01/0001 – 12/0018
Neni 11, Aneksi IC, Aneksi III	6. Përcaktimi i trajtimit dhe standardeve të efluentëve (mbetjeve të lëngëta) për ujërat e ndotur industrial	MMPAU / Agjenci Mjedisore /Këshillat për Basenët e Lumenjve	01/0004 – 12/0005
Aneksi IA Aneksi IB tabela 2	7. Drejtimi dhe ngritja e kapaciteteve	MMPAU	01/0001 – 12/0002
(Direktiva mbi Lumin nga Ujërat e Zeza)	8. Sistemi i administrimit të llumit nga ujërat të zeza	Autoriteti Kompetent + aktorët	01/0003 – 12/0004
Aneksi II	9. Krijimi i sistemit monitorues,	MMPAU	01/0002 –

	forcimi i inspektimit	/Këshillat për Basenët e Lumenjve	12/0003
Aneksi I	10. Vlerësimi dhe përmirësimi i kapaciteteve të nevojshme laboratorike në nivel kombëtar dhe rajonal	MMPAU / Këshillat për Basenët e lumenjve / Bashkitë	01/0000 – 12/0001
-	11. Krijimi i sistemit të këshillimit dhe raportimit	MMPAU	01/0003 – 12/0004

Këto 11 veprime kryesore janë ndarë në nën-veprime përbërëse dhe diskutohen në pjesët që vijojnë.

1 Krijimi i Autoriteteve Kompetente (AK) në nivel kombëtar

1.1 AT për organizimet institucionale

Duhet të mendohet me kujdes për organizimet institucionale. Duhet të ketë autoritete dhe organizime institucionale në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal për zbatimin dhe detyrimin për zbatim të direktivës. Këto përfshijnë jo vetëm organizimet për hartimin e politikave, por edhe për zhvillimin e programeve për ngritjen e infrastrukturës së ITUUN, sigurimin e financimit për ndërtim dhe monitorimin e progresit gjatë ngritjes së infrastrukturës.

Projekti i AT do të punojë ngushtësisht me të gjithë aktorët për të:

- caktuar përgjegjësi të hollësishme midis MMPAU, ministrive të tjera të interesuara (përfshirë MPPTT, MF), bashkive, këshillave për basenët e lumenjve;
- rekomanduar procedurë, rrjedhën e punës, ndryshime në shpërndarjen e përgjegjësive ndërmjet institucioneve përkatëse si edhe marrëdhënien midis aktorëve kyç të sektorit;
- elaboruar plane financiare: burimet e fondeve për shfrytëzim, kontratat e shërbimeve, etj.;
- nxjerrë rekomandime për t'u aprovuar nga qeveria Shqiptare.

1.2 Krijimi / caktimi i autoriteteve kompetente

Krijohen autoritetet kompetente ose duke përdorur strukturat ekzistuese ose duke krijuar struktura të reja dhe bëhen organizime administrative për të siguruar që direktiva është zbatuar efektivisht brenda Rajonit të Basenit të Lumit.

1.3 Punësimi i personelit shtesë tek autoritetet kompetente

Në nivel kombëtar

- MMPAU: 3 persona, përfshirë 1 bazë të dhënash / ekspert për SIGJ
- MPPTT: 1 person

1.4 Trajnimi i personelit të Autoritetit Kompetent (& dhe institucioneve të tjera kryesore, p.sh. këshillat e basenëve të lumenjve, bashkive, si të jetë e nevojshme)

Trajnimi mund të përfshijë, për shembull:

- ekonomiks

- teknika të avancuara të TUP
- monitorim
- pjesëmarrjen e publikut
- SIGJ
- procesin e planifikimit
- proceset e zgjeruara TUP dhe ato të ligatinave

1.5 Prokurimi i paisjeve kompjuterike (hardware-ve) dhe programeve (software-ve) për autoritetet kompetente

Prokurimi i paisjeve dhe programeve shtesë përveç paisjeve normale në tavolinën e punës (të përfshira në punësim), p.sh. printera me ngjyra me format të madh, printera ploter, software për bazë të dhënash dhe SIGJ, modele hidrologjike / të basenëve të lumenjve, software për administrimin e e projektit, etj.

1.6 Krijimi i një baze të dhënash të integruar për ujërat e ndotur dhe SIGJ

Duhet krijuar një bazë të dhënash e detajuar dhe e plotë me qëllim që të bëhet kontrolli i konformitetit (respektimit), administrimi i të dhënave dhe prezantimi i të dhënave për vendimarrje. Baza e të dhënave do të përfshijë informacion mbi:

- aglomeratet
- sistemet e grumbullimit të UUN
- impjantet TUUN
- entin përgjegjës
- të dhënat mbi zonat sensitive dhe basenët e lumenjve
- monitorimin e të dhënave
- të dhënat mbi laboratorët dhe kontrollin e cilësisë
- bazën e të dhënave me gjeo-referencë (ku është e përshtatshme) dhe inputin në SIGJ.
- lidhjen me bazën e të dhënave për burimet ujore siç është planifikuar për DKU

2 Identifikimi i zonave Sensitive dhe Aglomerateve

Identifikimi i zonave sensitive nuk është bërë ende. MMPAU duhet të vendosë nëse duhet të identifikojë zonat individuale sensitive apo të aplikojë kriteret më strikte/rigoroze për trajtim terciar për të gjithë territorin. Informacioni mund të përftohet duke kryer studime, dhe / ose duke përdorur të dhënat e disponueshme aktualisht. Aglomeratet, siç përcaktohet në Direktivë, duhet gjithashtu të identifikohen dhe të deklarohen zyrtarisht nga Qeveria. Caktimi i aglomerateve është gjithashtu i rëndësishëm për elaborimin e Master Planit për Ujin dhe Planeve të Administrimit të Basenëve të lumenjve.

2.1 AT në identifikimin e zonave sensitive, aglomerateve

Parashikohet që këto aktivitete të rëndësishme përgatitore fillimisht do të mbështeten nga një projekt AT, i cili:

- do të ndihmojë të vendosë nëse duhen identifikuar zonat individuale sensitive apo të aplikohen kriteret më strikte të trajtimit terciar për të gjithë territorin.
- nëse duhet bërë identifikimi, do të hartojë dhe nxjerrë përkufizime të sakta dhe kriteret për zonat sensitive; në mënyrë të veçantë, kjo gjë do të specifikojë kriteret shkencore të përdorura për të përcaktuar gjendjen eutrofike të rrjedhave ujore dhe burimeve ujore;
- do të identifikojë zonat sensitive dhe kufijtë e tyre të shtrirjes;
- brenda zonave sensitive, do të përcaktojë cili nga parametrat për trajtim më strikt specifikuar në Aneksin I.B duhet aplikuar në situata të veçanta;
- do të hartojë një draft rregullore për rivlerësimin e kriterëve dhe zonave sensitive;
- do të zhvillojë një plan për anketime vijuese;
- do të identifikojë (një) aglomerat/e me (a) > 15,000 e.p., (b) 10,000-15,000 e.p. (c) 2000-10,000 e.p.

Brenda zonave sensitive, duhet bërë një përcaktim se cili nga parametrat për një trajtim më shumë strikt (Aneksi I.B) duhet aplikuar (në këtë kontekst, në përgjithësi fosfori është faktori limitues për ujërat e ëmbël). Në këtë drejtim, do të ketë një mbivendosje të ngushtë me Direktivën mbi Nitratet (91/676/KE).

Presupozohet se nuk do të kërkohet asnjë shfuqizim i pjesshëm i ligjit për zonat më pak sensitive, meqë deti Adriatik nuk konsiderohet si një zonë më pak sensitive. Të gjitha shkarkimet, që vijnë nga aglomeratet më të mëdha se 10,000 e.p. brenda të njëjtës zonë sensitive, do të duhet të kalojnë në trajtim shumë strikt për ujërat e ndotur.

Zonat sensitive duhet të rivlerësohen çdo 4 vjet.

3 Projekti mbi aspektet financiare të zbatimit të DUUN

Qëllimi i këtij projekti do të jetë i dyfishtë: të largojë pengesat financiare për krijimin e infrastructures së impjanteve të duhura për trajtimin e ujërave urbanë të ndotur dhe të sigurojë një bazë për rikuperimin e kostove nga përdoruesit e ujit / prodhuesit e ujërave të zeza. Projekti do të përmbajë komponentët e mëposhtëm:

- Zhvillimin e një metodologjie standarte për llogaritjen e tarifave të grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur, që siguron, të paktën në periudha afatmesme, rikuperimin e të gjitha kostove nga përdoruesit/ndotësit, përfshirë kostot kapitale dhe ato të mirëmbajtjes. Hartimin e legjislacionit sekondar për t'i dhënë kësaj metodologjie një status detyrues. Metoda duhet të përfshijë udhëzime mbi mekanizmat e grumbullimit. Propozimi i një përqsasjeje për t'u marrë me çështjen e përballueshmërisë (së kostove);
- Përmirësimin e metodave për koordinimin e fondeve të donatorëve dhe sigurimin që këto fonde janë kanalizuar në projektet e duhura;

- Identifikimin e kufizimeve mbi marrjen borxh nga autoritetet e pushtetit vendor: ndalimi i kritereve strikte, mos-gadishmëria e pushtetit qendror për të ofruar garanci absolute, mungesa e tregut të bonove të pushtetit vendor, praktikat e dobëta financiare dhe mungesa e kapaciteteve financiare në bashki, mungesa e legjislacionit në shoqatat e bashkive. Formulimi i planit të veprimit për t'u përballur me këto kufizime, në bashkëpunim me të gjithë aktorët.
- Sigurimin e informacionit bashkive, në lidhje me mekanizmat e ndryshme për të financuar ndërtimin dhe përmirësimin e nevojshëm: IAP, financime nga grante të tjera, IFN të tjera, partneritete me sektorin privat (konçesione, NSHT etj.)
- Përcaktimin e kritereve për përcaktimin e projekteve përparësore
- Krijimin e insentivave (motivacioneve) /sistemit të monitorimit /sanksioneve për të siguruar që pushteti vendor do të proçedojë me ndërtimin e strukturave sanitare
- Hartimin e termave standarte të referencës për studime fizibiliteti për projekte sanitare të pranueshme nga ana e bankave.
- Zhvillimin e proçedurave, lëvrimin e seancave të trajnimit, hartimin dhe shpërndarjen e manualeve mbi tenderimet dhe kontraktimet.

3.1 Asistenca Teknike

Një projekt asistence teknike është i dëshirueshëm për të mbështetur aktivitetet e mësipërme.

3.2 Krijimi i projekteve ne zhvillim

MPPTT ose një institucion tjetër duhet të disponojë projekte ne zhvillim të pranueshme nga ana e bankave me qëllim që të aksesohen fondet nga IAP dhe burime të tjera, përfshirë përcaktimin e përparësive. Diskutime me BE-në, IFN, për të mbështetur bashkitë.

4 Sigurimi dhe trainimi i burimeve njerëzore të Bashkive

Personel i ri do të jetë i nevojshëm tek bashkitë për të shpallur thirrje për tendera dhe për t'i vlerësuar ato, për të mbajtur marrëdhëniet me institucionet kredidhënëse, pushtetin qendror, ndërmarrjet private, për të organizuar/planifikuar faturimet, etj.

4.1 Punësimi i personelit të ri në bashki. 196 epkp, korrespondon me 1 për çdo aglomerat

Rekrutimi do të shpërndahet përgjatë një numri vitesh, në hap me investimin dhe instalimin e një infrastrukture të re.

4.2 Projekt AT për të hartuar materiale trajnimesh dhe lëvruar trajnime pilotë në bashkitë pionere

- Hartimi dhe prodhimi i materialeve të trajnimit për punonjësit bashkiakë.

- Trajnimi i punonjësve bashkiakë: tarifat, tenderimi, PPP, financat bashkiake, subjekte të tjera siç jepet në 1.4. Marrja e mendimeve / komenteve për të përmirësuar materialet. Punonjësit e përfshirë do të jenë nga bashkitë e para që do të përmirësojnë infrastrukturën e tyre për ujërat e ndotur.
- Trajnimi i trainerëve. Një bërthamë me njerëz lokalë të përshtatshëm do të integrohet në ekipin trainues, dhe do të marrin përsipër aktivitetin e trajnimit pas përfundimit të projektit të AT.

4.3 Trajnimi i zyrtarëve të bashkive të tjera sipas kohës së nevojshme të caktuar

Përdorimi i trainerëve lokalë, të trainuar si pjesë e 4.2.

5 Ngritja e infrastrukturës (rrjetet e ujërave të ndotur dhe impjantet për trajtimin e ujërave urbanë të ndotur)

MMPAU në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve Publike duhet të krijojë një program zbatimi për ndërtimin e rrjeteve të ujërave të zeza dhe impjanteve për trajtimin e ujërave të ndotur.

5.1 Krijimi i një programi zbatimi për DTUUN

Kjo gjë kërkohet në përputhje me Nenin 17. Programi i zbatimit duhet të rishikohet çdo dy vjet sapo Shqipëria të jetë anëtare e BE-së. Ky PZDS do të shërbejë si bazë për programin e parë të zbatimit. Ngritja e infrastrukturës është planifikuar në etapa, ku i jepet përparësi aglomerateve me më shumë se 20,000 e.p. (për më shumë informacion shih 3.4).

5.2 Etapa 1: aglomeratet > 20,000 e.p. (ka 19 aglomerate të tilla)

- Studime fizibiliteti / aplikime për financim;
- Projektimi i sistemeve të grumbullimit dhe ITUN; një aspekt i rëndësishëm i projektit do të jetë vlerësimi i infrastrukturës ekzistuese dhe parashikimi se ku duhen bërë përmirësime
- Ndërtimi i sistemeve grumbulluese
- Projektimi dhe ndërtimi i ITUN

5.3 Etapa 2: aglomeratet 5,000 - 20,000 e.p. (ka 59 aglomerate të tilla)

- Studime fizibiliteti / aplikime për financim
- Projektimi i sistemeve të grumbullimit dhe ITUN
- Ndërtimi i sistemeve grumbulluese
- Projektimi dhe ndërtimi i ITUN

5.4 Etapa 3: aglomeratet 2,000 – 5,000 e.p. (ka 118 aglomerate të tilla)

- Studime fizibiliteti / aplikime për financim
- Projektimi i sistemeve të grumbullimit dhe ITUN
- Ndërtimi i sistemeve grumbulluese
- Projektimi dhe ndërtimi i ITUN

6 Krijimi i standarteve të trajtimit dhe të mbetjeve të lëngëta, rregjimi i autorizimit paraprak, për ujërat e ndotur industriale

6.1 Projekti i AT për të krijuar trajtimin standard dhe standartet e mbetjeve, rregjimi i autorizimit paraprak, për ujërat e ndotur industrial.

Këtu ka dy aspekte:

1. Kërkesa e Nenit 11, shkarkimi i ujërave industriale të ndotur në sistemet e grumbullimit dhe impjantet e trajtimit të ujërave urbanë të ndotur i nënshtrohet rregulloreve paraprake dhe / ose autorizimeve specifike, është hartuar që të sigurojë konformitet / respektim të kriterëve të Aneksit I.C dhe,
2. Kërkesa e Nenit 13, ujërat e ndotura industriale të biodegradueshme, për sektorët e Aneksit III nga impjantet > 4000 e.p. të, cilat nuk hyjnë në impjantet e trajtimit të ujërave urbanë të ndotur, por shkarkohen direkt i nënshtrohen rregulloreve paraprake dhe / ose autorizimeve specifike.

Në radhë të parë, projekti do të ketë nevojë të bëjë një inventar të shkarkimeve përkatëse. Projekti do të duhet të përcaktojë nëse standartet do të jenë kombëtare ose lokale, dhe nëse aplikohen si rregullore apo kushte në lejet individuale. Standartet duhet të jenë të përshtatshme për industrinë e veçanta përkatëse dhe do të përfshijnë konsultimet me sektorët e industrisë. Standartet për shkarkimet e tipit të parë të sipërpërmendur do të varen pjesërisht nga ajo çka do të jetë rruga e propozuar e depozitimit / asgjësimit të llumrave të ujërave të zeza (shih kriterin e fundit të Aneksit I.C). Nëse llumrat e ujërave të zeza do të përdoren në bujqësi, atëherë standarte më shumë strikte mund të jenë të nevojshme për të siguruar që llumrat plotësojnë standartet e duhura të cilësisë (sipas Direktivës mbi Llumrat nga Ujërat e Zeza 86/278/KEE). Do të hartohet legjislacioni i nevojshëm dhe / ose do të përpilohen klauzolat e nevojshme për lejueshmërinë, përfshirë hartimin e kushteve të modelit.

6.2 Rekrutimi i personelit shtesë për rregjimin e autorizimit paraprak (nëse duhet)

Nëse do të prezantohet rregjimi i autorizimit paraprak, atëherë do të jetë i nevojshëm personel shtesë për të procesuar aplikimet dhe për të përgatitur kushtet që aplikohen.

6.3 Zbatimi i Nenit 11 standartet e shkarkimit

Stabilimentet e ndikuara do të duhet të marrin çdo lloj mase teknike dhe organizative të nevojshme për të përmbushur / respektuar standartet.

6.4 Zbatimi i Nenit 13 standartet e shkarkimit

Stabilimentet e ndikuara do të duhet të marrin çdo lloj mase teknike dhe organizative të nevojshme për të përmbushur / respektuar standartet.

7 Drejtimi dhe ngritja e kapaciteteve

7.1 AT për elaborimin dhe shpërndarjen e dokumentave udhërrëfyese

Një sërë dokumentash udhërrëfyese duhet të përgatiten dhe shpërndahen tek politikëbërësit, operatorët, palët e tjera të interesuara, që mbulojnë për shembull temat e mëposhtme:

- Përkufizimi i saktë që duhet përdorur për zonat sensitive (shpjegimi në Aneksin II);
- Projektimi, ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrjeteve të kanalizimeve, bazuar të paktën në klauzolat e direktivës. Një udhërrëfyese i tillë duhet të adresojë gjithashtu çështjen e kufizimit të ndotjes nga vërshimet në sistemet e kombinuara të kanalizimeve të ujërave të zeza. Dokumente udhërrëfyese teknike të krahasueshme nga vendet e tjera, përgatitur nga autoritetet kombëtare ose rajonale, shoqatat teknike ose shoqata të tjera, mund të jenë të dobishme në këtë këndvështrim.
- Projektimi, ndërtimi dhe mirëmbajtja e impjanteve të trajtimit të ujërave të ndotur; dokumente udhërrëfyese teknike të krahasueshme nga vendet e tjera, përgatitur nga autoritetet kombëtare ose rajonale, shoqatat teknike ose shoqata të tjera, mund të jenë të dobishme në këtë këndvështrim. Atje ku duhet, dokumentat udhërrëfyese duhet të përgatiten me alternativa të përshtatshme për sistemet e grumbullimit, që të sigurojnë të paktën të njëjtin nivel mbrojtjeje mjedisore. Konformiteti / respektimi mund të ishte një kusht për autorizim ose autorizim të vazhdueshëm të ITUN;
- Si mund të vihet në funksionim në situata praktike koncepti 'trajtimi i duhur'; një trajtim i tillë duhet të sigurojë cilësinë e mirë të nevojshme të ujërave bujtës.

8 Sistemi i administrimit të llumrave të ujërave të zeza

8.1 AT për ripërdorim ose depozitimin / asgjesimin e llumrave të ujërave të zeza në mënyrën e duhur nga ana teknike dhe mjedisore

Studimi do të shqyrtojë cilat janë opsionet për ripërdorimin ose depozitimin / asgjesimin e llumrave të ujërave të zeza në mënyrën e duhur nga ana teknike dhe mjedisore, do të identifikojë veprimet që duhet të ndërmerren për t'i zbatuar këto opsione, do të nxjerrë rekomandimet për zgjedhjen më të

mirë, do të adoptojë kritieret dhe do të përgatisë udhëzimet. Opsionet mund të përfshijnë:

- Përdorimin si pleh organik / përmirësues i tokës në bujqësi;
- Incinerimin në një furnaltë çimentoje (por kjo mund të nënkuptojë se furnalta prej çimentoje duhet të respektojë kërkesat e Direktivës mbi Incinerimin e Mbetjeve 2000/76/KE);
- Përdorimin si materiale mbuluese në fushëgrumbullime (landfille);
- Depozitimin në një fushëgrumbullimi (landfill), subjekt i Direktivës mbi Fushëgrumbullimin (Landfillin) e Mbetjeve (99/31/KE).

Projekti mund të ketë nevojë gjithashtu të hartojë legjislacionin përkatës, për shembull për të ndaluar çdo lloj depozitimi të llumrave nga ujërat e zeza në ujërat sipërfaqësorë.

9 Krijimi i sistemit monitorues, forcimi i inspektimit

MMPAU duhet të krijojë një program monitorimi dhe inspektimi për vlerësimin e konformitetit / respektimit të kërkesave në lidhje me shkarkimet nga impjantet e trajtimit të ujërave urbanë të ndotura dhe për vlerësimin e sasive dhe përbërjes së llumit. Ky monitorim duhet të jetë pjesë e monitorimit gjithëpërfshirës siç përshkruhet në Direktivën Kuadër mbi Ujërat (2000/60/KE). Kapaciteti i institucioneve monitoruese duhet të përmirësohet dhe numri i pikave të monitorimit dhe numri i kampioneve të marra duhet të shtohen.

Këto kërkesa rrjedhin nga Neni 15, i cili kërkon që AK-të të monitorojnë:

- Shkarkimet nga impjantet e trajtimit të ujërave urbanë të ndotur të cilat duhet të jenë në përputhje me standartet e përcaktuara në Direktivë për shkarkimet;
- Sasitë dhe përbërjen e llumrave të depozituar në ujërat sipërfaqësorë;
- Ujërat që janë subjekt i shkarkimeve nga impjantet e trajtimit të ujërave urbanë të ndotur dhe shkarkimeve direkte siç përshkruhet në Nenin 13 në rastet kur pritet që mjedisi bujtës do të ndikohet në mënyrë të konsiderueshme / drastike;

9.1 Inspektimi shtesë – rekrutimi i personelit

Rrjedhimisht, do të duhet të punësohen inspektorë shtesë. Prezupozohet se do të kërkohet si personel shtesë ekuivalenti i një personi me kohë të plotë.

9.2 Planifikimi i buxhetit operativ

Do të jetë i nevojshëm buxheti për të mbuluar shpenzimet e nevojshme: udhëtimet e inspektorit, kostot e analizave kimike, etj.

9.3 Monitorimi i llumrave

Inspektimet e ITUN do të jenë të nevojshme për të siguruar që llumrat janë duke u trajtuar në mënyrën e duhur (p.sh. u largohet uji) dhe depozitohen / asgjesohen në përputhje me autorizimin e instalimit.

9.4 Monitorimi i ujërave ku janë të mundshme impaktet madhore

Kjo gjë në fakt krijon një pjesë të programit për monitorimin e cilësisë së ujërave siç parashikohet nën Direktivën Kuadër mbi Ujërat.

10 Vlerësimi dhe përmirësimi i kapaciteteve laboratorike të nevojshme në nivel kombëtar dhe rajonal

MMPAU duhet të sigurojë kapacitete laboratorike të mjaftueshme ose brenda administratës ose nëpërmjet nënkontraktimit të laboratorëve tregtare të akredituar dhe liçensuar. Skemat e akreditimit për të gjithë laboratorët janë një mjet për të siguruar vazhdimisht një kontroll cilësie të tillë. Laboratorët duhet të përdorin metodat e specifikuara në Aneksin I të Direktivës dhe duhet t'i nënshtrohen rregullisht kontrollit të cilësisë. Qeveria duhet të sigurojë kontrollin e cilësisë me laboratorët e përfshirë përmes ekzaminimit të kryer nga personeli i kualifikuar dhe me njohuri në këtë fushë. Metodatat e marrjes së kampioneve dhe analizës duhet të respektojnë kërkesat e Direktivës. Presupozohet se, aktivitetet e identifikuara në PZDS për Direktivën Kuadër të Ujit, në këtë drejtim, do të jenë të mjaftueshme për të siguruar kapacitete laboratorike adekuate (të mjaftueshme) për këtë Direktivë gjithashtu.

11 Raportimi dhe konsultimi

11.1 Raportet tek publiku dhe Komisioni

Autoriteteve përkatëse iu kërkohet të publikojnë raporte për publikun çdo dy vjet mbi depozitimin / asgjesimin e ujërave urbanë të ndotur dhe llumrave në zonat e tyre. (Neni 16). Gjithashtu autoritetet kanë një sërë detyrimesh për të raportuar tek Komisioni (shih pikën e fundit të 1.3). Raportimi do të jetë përgjegjësi e autoriteteve kompetente, por presupozohet që mund të jetë e nevojshme mbështetja e jashtme (konsulenca lokale, hartëzimi, printimi).

11.2 Konsultimi

Qeveria duhet të sigurojë gjithashtu bashkëpunim të kënaqshëm dhe shkëmbim informacioni me Shtetet e tjera Anëtare në rastet ku shkarkimet e ujërave të ndotur kanë efekt ndërkuftar tek cilësia e ujit në ujërat e përbashkët.

Njëmbëdhjetë veprimet e identifikuara për zbatim mund të përmbledhen në pesë grupet kryesore të veprimeve si më poshtë:

1. Forcimi institucional dhe ngritja e kapaciteteve;
2. Puna përgatitore;
3. Mbledhja dhe trajtimi i ujërave të ndotur;
4. Depozitimi / asgjesimi i llumrave dhe ujërave të ndotur të trajtuar;

5. Monitorimi, mbajtja e të dhënave dhe raportimi.

3.4 Plani paraprak i investimit për infrastrukturën e ujërave të ndotur

Direktiva mbi Trajtimin e Ujërave Urbanë të Ndotur është një nga elementët me kosto më të madhe të acquis-ë mjedisore, dhe do të përfshijë një program madhor investimesh në infrastrukturën e ujërave të ndotur gjatë 15 – 29 viteve të ardhshme. Në këtë pjesë është zhvilluar një plan paraprak bazuar tek informacioni i disponueshëm për momentin. Plani mund të perfeksionohet gradualisht ndërkohë që kryhen kërkime paraprake dhe mbledhje të dhënash, studime fizibiliteti, etj., ashtu siç përshkruhen më sipër.

Ky plan paraprak u zhvillua në etapat e mëposhtme:

- Identifikimi i aglomerateve urbane në rajonet e basenëve të lumenjve bazuar tek të dhënat e popullsisë dhe informacioni gjeografik.
- Vlerësimi i nevojave për sistemet e grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur në bazë të informacionit mbi strukturat ekzistuese.
- Përzgjedhja e zonave sensitive dhe zonave të tjera me kërkesa specifike për mbrojtjen e burimeve ujore.
- Projektimet paraprake dhe përlllogaritja e kostove për sistemet e grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur për aglomeratet.

3.4.1 Përzgjedhja e aglomerateve

Aglomeratet janë përzgjedhur në bazë të hamendësimeve të mëposhtme:

1. Përkufizimi i rajoneve të basenëve të lumenjve
2. Proçedurat për identifikimin e aglomerateve

1. Rajonet e baseneve të lumenjve

Territori i Shqipërisë mbulon 6 rajone të basenëve të lumenjve, përkatësisht:

- Rajoni i basenit të lumit Seman
- Rajoni i basenit të lumenjve Drin-Shkodër-Bunë
- Rajoni i basenit të lumit Mat
- Rajoni i basenit të lumenjve Ishëm dhe Erzen
- Rajoni i basenit të lumit Shkumbin
- Rajoni i basenit të lumit Vjosë

Disa pjesë të Shqipërisë nuk i përkasin këtyre basenëve të lumenjve pasi ato derdhen drejt e në det. Për qëllime të administrimit të ujërave rekomandohet që pjesë të tilla të inkorporohen në rajonet e basenëve të lumenjve. Në këtë drejtim, propozohet që rajonet bregdetare dhe liqenore të inkorporohen në rajonet e basenëve të lumenjve si më poshtë:

- Rrethet Malësi e Madhe dhe Shkodër janë inkorporuar në rajonin e basenit të lumit Drin.
- Rrethet Lezhë dhe Kurbin janë inkorporuar në rajonin e basenit të lumit Mat.
- Rrethet Durrës dhe Kavajë janë inkorporuar në rajonin e basenit të lumenjve Ishëm dhe Erzen.
- Rrethet Lushnjë, Fier, Pogradec, Devoll dhe Korçë janë inkorporuar në rajonin e basenit të lumit Seman.

- Rrethet Vlorë, Sarandë dhe Delvinë janë inkorporuar në rajonin e basenit të lumit Vjosë.

2. Identifikimi i aglomerateve

Aglomeratet e ligjshme janë identifikuar kryesisht në bazë të a) të dhënave mbi popullsinë nga Raporti⁴ Census 2001, b) të dhënave aktuale që janë marrë nga disa bashki dhe komuna si edhe informacionit topografik.

Përzgjedhja paraprake e aglomerateve është bërë mbi bazat e mëposhtme:

- Të gjitha qendrat e banuara me një popullsi me 2,000 banorë ose më shumë duhet të kenë sisteme për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotur. Në këtë fazë presupozohet që në përgjithësi një bashki ose një komunë mund të shërbehet nga një impjant qendror trajtimi për ujërat e ndotur, tek i cili qendrat e banuara individuale lidhen nëpërmjet tubacioneve.
- Në komunat ku nuk ka qendra të banuara prej më shumë se 2,000 banorë mund të jetë e mundur që qendrat e banuara të urbanizuara që shtrihen aty pranë të kombinohen në aglomerate me më shumë se 2,000 banorë. Aglomerate të tilla duhet të kenë gjithashtu sisteme të grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur sipas Direktivës TUUN. Për këtë arsye të gjitha komunat me qendra banimi prej me më shumë se 1,000 banorë janë identifikuar gjithashtu si potencialisht të ligjshme (gëzojnë të drejtën) sipas Direktivës TUUN. *Më shumë studime të detajuara kërkohet të kryhen për përzgjedhjen përfundimtare të aglomerateve të tilla.*
- Në përzgjedhjen e aglomerateve, bashkitë dhe komunat mund të kombinohen në një aglomerat kur është me leverdi ekonomike të trajtohen të gjitha ujërat e ndotur nga aglomerati në një impjant qendror për ujërat e ndotur. Në parim, trajtimi i centralizuar i ujërave të ndotur mund të jetë një zgjidhje teknike me leverdi me kusht që:
 - distanca e qendrave të banuara deri tek ITUN është më pak se 10 km,
 - qendrat e banuara dhe ITUN janë të lokalizuara në të njëjtin vend drenazhimi,
 - topografia është e përshtatshme për lidhjen e qendrave të banuara me ITUN.

Përzgjedhja e aglomerateve është bërë gjithashtu në bazë të të dhënave topografike. Numrat e popullsisë së aglomeratit janë parashikuar në bazë të Raportit 2001 dhe të dhënave të popullsisë aktuale, atje ku janë të disponueshme. Ngarkesat e vlerësuara të mbetjeve (si numër i ekuivalentëve të personave) janë ekuivalent me numrin e popullsisë. Për aglomeratet më të mëdha (> 25,000 banorë) ngarkesa e vlerësuar e mbetjeve është llogaritur si shumë e numrit të popullsisë me 20% të numrit të popullsisë, që përbëjnë ngarkesat e ujërave të ndotur industrialë dhe institucionalë.

⁴ Raporti Census 2001 ofron të dhëna mbi popullsinë e të gjitha bashkive dhe komunave, si edhe të qendrat e banuara që janë pjesë e komunave.

Në Tabelën e mëposhtme jepet një përmbledhje e aglomerateve të përzgjedhura. Të dhëna më të hollësishme janë dhënë në Aneksin V.

Tabela 6: Përmbledhje e aglomerateve të përzgjedhura

Rajonet e baseneve të lumenjve	Numri i komunave	Numri i aglomerateve	Ngarkesa e ujërave të ndotur (e.p.)
Seman	99	49	626,800
Drin-Shkodër-Bunë	81	42	288,200
Mat	36	24	173,200
Ishëm-Erzen	44	25	1,328,300
Shkumbin	47	28	278,700
Vjosë	67	28	286,500
Totali	374	196	2,981,700

3.4.2 Përzgjedhja e zonave sensitive dhe të mbrojtura

Zonat sensitive janë përcaktuar si zona të cilat janë sensitive për kushtet eutrofike ose mund të bëhen eutrofike. Në përgjithësi këto janë trupa ujorë me ujë të palëvizshëm (stanjant), siç janë liqenet, dhe lumenjtë e përrenjtë me rrjedhë të ngadaltë, të cilët ndërkohë tregojnë shpesh përqëndrime të larta Azoti dhe / ose Fosfori. Zonat që karakterizohen nga një normë e lartë infiltrimi (p.sh. zonat karstike) duhet të konsiderohen sensitive gjithashtu, meqenëse hyrja e ujërave të ndotur në zona të tilla mund të rezultojë në përqëndrime të larta N dhe P në ujërat nëntokësorë. Të gjithë trupat ujorë që përdoren për banjë (plazh), peshkim, kultivimin e molusqeve dhe mbrojtjen e natyrës kategorizohen gjithashtu tek zonat sensitive.

Në Shqipëri, trupat ujorë, që janë sensitivë ndaj eutrofikimit, nuk janë përzgjedhur ende. Aktualisht, nuk ka të dhëna të mjaftueshme të disponueshme për të shpallur /përcaktuar zonat sensitive siç kërkohet nga Direktiva mbi TUUN. Për momentin presupozohet që të gjitha trupat ujorë sipërfaqësorë do të shpallen / përcaktohen si 'zona sensitive' në sensin e Direktivës derisa të merren vendime zyrtare në lidhje me këtë çështje.

Nuk është kryer ende as klasifikimi i trupave ujorë në lidhje me përcaktimin e synimeve / objektivave specifike mbi cilësinë e ujit për trupa të ndryshëm ujorë, nëpërmjet atributimit të një klasi cilësie të ujit për të gjithë trupat ujorë sipërfaqësorë. Një klasifikim i tillë sipas cilësisë së ujit do të rezultonte gjithashtu në kufizimet e shkarkimeve të ujërave të ndotur në trupat ujorë të cilët duhet të mbrohen me qëllim që të realizohen objektivat për cilësinë e ujit.

Zona të tjera të mbrojtura tek të cilat mund të aplikohen kufizime për shkarkimin e ujërave të ndotur përfshijnë zonat e nxjerrjes së ujit të pijshëm dhe rezervat natyrore. Disa të dhëna mbi zonat e mbrojtura janë dhënë në tabelën e mëposhtme:

Tabela 7: Zonat e mbrojtura

Tipi	Numri	Sipërfaqja (ha)
Zonë tepër e mbrojtur	4	14,500
Park kombëtar	12	25,890
Monument natyre	300	4,360
Zonë e administruar	26	42,960
Peisazh i mbrojtur	5	59,200
Burim i mbrojtur	4	18,245
Totali		164,110

3.4.3 Projektimi paraprak dhe përlogaritja e kostove për sistemet e grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur

Për secilin nga aglomeratet, janë përlogaritur kostot paraprake të investimit për sistemet e grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur.

Për aglomeratet midis 2,000 dhe 10,000 e.p. kostot janë përlogaritur mbi bazën e trajtimit sekondar.

Për aglomeratet më të mëdha se 10,000 e.p. kostot janë përlogaritur në bazë trajtimit të avancuar me efikasitet më të lartë largimi të Azotit dhe Fosforit me qëllim që të përmbushen kërkesat e cilësisë së efluentëve (mбетjeve të lëngëta) që shkarkohen në zonat sensitive.

Për aglomeratet mund të merren në konsideratë gjithashtu edhe metodat alternative të trajtimit të ujërave të ndotur, siç janë sistemet e pellgjeve (húrdhive) dhe ligatinave artificiale të cilat mund të rezultojnë në një reduktim të ndjeshëm të kostove operative dhe atyre të ndërtimit. Përzgjedhja e sistemeve të tilla varet kryesisht nga disponibiliteti i hapësirës tokësore të përshtatshme.

Hamendësime të bëra në përlogaritjen e kostos

Për të përlogaritur kosto të tilla, duhen bërë një sërë hamendësimesh. Disa nga hamendësimet e përgjithshme janë trajtuar këtu. Hamendësime të tjera më të detajuara për llogaritjen e kostove të investimit dhe kostove operative e të mirëmbajtjes janë prezantuar në Aneksin VI.

Kostot totale të përlogaritura për sistemet e grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur janë përfshirë gjithashtu në Aneksin VI.

Llogaritjet e kostos për sistemet e grumbullimit të ujërave të ndotur përfshijnë një fond kontigjence prej 30% për shkak të pasigurive në llogaritjen e kostove. Të gjitha përlogaritjet e kostos përjashtojnë kostot e tokës së kërkuar për këto sisteme.

Të gjitha vlerësimet e kostove janë bërë nën hamendësimin që për të gjitha aglomeratet duhen ndërtuar tërësisht sisteme të reja kanalizimesh dhe impjante trajtimi për ujërat e ndotur, megjithëse kostot e llogaritura janë reduktuar disi në rastet kur ka patur të dhëna të disponueshme që një pjesë e aglomeratit ka patur kanalizime.

Ekzekutimi i planeve për ndërtimin e sistemeve të grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur duhet të konsiderohet si pjesë e integruar e planeve për përmirësimin e infrastrukturës urbane dhe mjedisit. Në këtë kontekst përparësi më e madh mund t'i jepet përmirësimit të sistemeve të furnizimit me ujë të publikut deri sa të arrihen standartet e kërkuara.

Plani i administrimit të ujërave të ndotur mund të zbatohet në 3 faza përgjatë një periudhe kohore prej 15 deri 20 vjetësh. Me aglomeratet që janë më të mëdhatë, me një ngarkesë mbetjesh të llogaritur > 20,000 e.p. duhet të operohet gjatë Fazës I.

Në Fazat II dhe III, duhet operuar respektivisht me aglomeratet me një ngarkesë mbetjesh prej 5,000 – 20,000 e.p. dhe me një ngarkesë mbetjesh prej 2,000 – 5,000.

Të dhënat për 3 kategoritë e ndryshme sipas diapazonit të madhësisë së aglomerateve janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme (për më shumë informacion lutemi shihni Aneksin VI).

Kategoritë e aglomerateve sipas diapazonit të madhësisë

Diapozoni i madhësisë (e.p.)	Nr. i Aglomera-teve	Ngarkesa totale e ujit të ndotur (e.p.)	Kostot e Investimit (€)	
			ITUN	Kanalizime
I. > 20000	19	2,172,000	333,120,000	564,590,000
II 5000 - 20000	59	486,800	170,311,800	244,730,200
III. 2000 - 5000	118	322,900	180,073,100	172,395,600
TOTALI	196	2,981,700	683,504,900	981,715.800

Tirana, duke qenë aglomerati më i madh me 1,000,000 e.p., ka edhe përparësinë më të madhe për ekzekutimin e projektit, meqë pakësimi i ngarkesës së mbetjeve shoqërohet me efektivitetin më të lartë të kostove, dhe do të rezultojë në një përmirësim të madh të cilësisë së ujit të lumit Lanë si edhe të lumenjve Ishëm dhe Erzen në rrjedhën e poshtme të Tiranës. Aglomerate të tjera të mëdha janë: Durrësi, Vlora, Fieri, Elbasani dhe Shkodra.

Hapi i parë në përgatitjen e një plani të detajuar për ndërtimin e një sistemi për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotur në aglomerate është kryerja e një studimi fizibiliteti për secilin nga aglomeratet, mundësisht në kombinim me studimin për vlerësimin e impaktit mjedisor (VIM) nëse kërkohet.

Studimi i fizibilitetit dhe studimi VIM do të rezultojnë në analizën vendimtare dhe përshkrimin e karakteristikave të aglomeratit, për sa i përket: numrit të popullsisë, qendrave të banuara të inkorporuara në të, popullsisë që nuk është e lidhur me kanalizimet qendrore, ngarkesat e ujit të ndotur, vendodhjen e zonave sensitive dhe të mbrojtura, projektimin paraprak të sistemit të kanalizimeve dhe ITUN me kostot e përlllogaritura, vendodhjen e ITUN, karakteristikat e efluentë-marrësve (mbetjeve të lëngëta), administrimin e ujit të ndotur për zonat që nuk janë të lidhura me sistemin e kanalizimeve, sistemin e propozuar për depozitimin / asgjësimin e llumrave.

Zgjidhje alternative duhet të eksploroohen dhe vlerësohen gjatë studimeve të fizibilitetit. Për më tepër studimi i fizibilitetit duhet të ofrojë një përshkrim të organizimit ekzistues të sistemit të furnizimit me ujë dhe administrimit të ujërave të ndotur në aglomerate si edhe të nevojave për forcim institucional dhe trajnim. Analiza financiare e ekonomike si edhe përgatitja e një plani financimi për investimet operative dhe të mirëmbajtjes duhet të jenë pjesë e këtyre studimeve të fizibilitetit.

Pas aprovimit të raportit të studimit të fizibilitetit (dhe raportit VIM) duhet të përgatitet një raport projekt i hollësishëm për ekzekutimin e planit. Ky raport përshkruan: projektin e detajuar të punimeve dhe llogaritjet e kostove, dokumentat e tenderit dhe planifikimin për ekzekutim.

Fazimi i masave dhe investimit

Direktiva është një nga direktivat me kosto më të lartë për t'u zbatuar pasi respektimi i kërkesave të saj do të kërkojë rinovim dhe zgjerim të konsiderueshëm të infrastrukturës ekzistuese në lidhje me ujërat e ndotur dhe sanitetin si edhe ndërtimin e një sistemi të ri për grumbullimin dhe transportin e ujërave të zeza dhe impjanteve për trajtimin e ujërave të ndotur. Veprimet e nevojshme do të fazohen në kohë, pjesërisht pasi këto veprime duhet të ndjekin një sekuençë llogjike e cila kërkon kohë të realizohet, por, kryesisht për shkak se kostot e zbatimit janë të larta dhe kostot kapitale janë intensive, dhe do të jenë të përballueshme vetëm nëse shpërndahen në disa vite. Është presupozuar se për qëllimin e këtij plan zbatimi të direktivës specifike, plani i përgjithshëm për ndërtimin dhe përmirësimin e sistemeve të grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur në aglomerate do të fazohet në 3 etapa gjatë një periudhe kohore prej 15 deri 20 vjetësh si vijon:

- Gjatë etapës së parë I (viti 1 deri në vitin 12) do të ndërtohen sistemet që janë më të mëdhatë (ITUN > 20,000 e.p.) Etapa I përfshin 19 aglomerate.
- Gjatë etapës II do të ndërtohen sistemet për aglomeratet me madhësi të ITUN prej 5,000 – 20,000 e.p. (viti 8 deri në vitin 15). Etapa II përfshin 59 aglomerate.
- Gjatë etapës III (viti 12 deri në vitin 18) do të ndërtohen sistemet për aglomeratet me madhësi të ITUN < 5,000. Etapa III përfshin 118 aglomerate.

Afati kohor aktual do të rimerret në konsideratë kur të ndërtohet tërësisht një strategji e përgjithshme, duke marrë parasysh implikimet dhe kërkesat e përgjithshme për burime, si edhe përparësitë e qeverisë për sa i përket direktivave të ndryshme.

Kostot e përlogaritura të investimit për sistemet e grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur për aglomeratet janë dhënë më poshtë. Të dhëna më të hollësishme mbi përlogaritjet e kostove dhe hamendësimet esenciale janë pasqyruar në Aneksin VI.

Tabela 9: Kostot totale të përlogaritura për investimin (në Euro)

	Punime Civile	Fondi i kontigjencës (reserve)	Projektimi, mbikqyrja, sigurimi i cilësisë / standarteve të ndërtimit	Totali
ITUN	683,504,900	68,350,490	136,700,980	888,556,370
Sistemet grumbulluese	981,715,800	294,514,740	196,343,160	1,472,573,700
TOTALI	1,665,220,700	362,865,230	333,044,140	2,361,130,070

4 Burimet dhe Kostot e Përgjithshme

4.1.1 Hyrje

Është bërë një përlogaritje e kostove për veprimet e ndryshme të nevojshme që duhen ndërmarrë për të realizuar përafrimin dhe zbatimin e Direktivës mbi Trajtimin e Ujërave Urbanë të Ndotur. Rezultatet e përcaktimit të kostos janë parashtruar më poshtë. Përqasja e ndjekur për të përcaktuar koston është përmbledhur në pjesën 3.5.2 dhe disa nga hamendësimet e përgjithshme të bëra janë përshkruar në pjesën 3.5.3.

4.1.2 Metoda e përlogaritjes së kostos dhe burimet për të dhënat e kostos

Pika e nisjes për të përcaktuar koston e zbatimit ishte lista e ndërhyrjeve që duhen bërë të dhëna në Tabelën 5.

Kërkesat për burim për secilin nga veprimet janë llogaritur nga ekspertët e projektit. Këto burime përmbajnë:

- projektin, ndërtimin dhe shfrytëzimin e infrastrukturës së grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur: metoda e përlogaritjes së kostove është përshkruar në pjesën 3.4.
- masat e tjera teknike dhe inxhinjerie
- burimet njerëzore (burimet në përgjithësi presupozhen të jenë burime të reja të cilat do të kërkohen në baza të vazhdueshme), bashkë me burimet normale të nevojshme për t'i lejuar ato të bëjnë punën e tyre (hapësira e zyrës, tavolina e punës, kompjuteri, kancelaritë, mbështetja administrative, etj.),
- trajnimin,
- udhëtimin,
- prodhimin e dokumentave të nevojshëm,
- ekspertët / projektet për asistencë teknike. (Burimi i alokuar për projekte të asistencës teknike është bazuar në parashikimet, duke u nisur nga eksperiencia, për inputet e nevojshme për sa i përket konsulentëve lokalë dhe ndërkombëtarë si edhe burimeve të tjera, të ofruara nga projektet e asistencës teknike (AT)
- instrumentat për marrjen e kampionëve,
- analizat e laboratorëve.

Kostot për këto burime janë llogaritur nga ekspertët e projektit. Kostot për njësi që janë përdorur për të llogaritur kostot e burimeve, u bazuan, atje ku ishte e mundur, tek të dhënat lokale, por në rastet kur të dhënat lokale nuk ishin të disponueshme, u përdorën kostot që aplikohen në vendet e tjera të Europës Jugore. Për më shumë informacion mbi mënyrën se si këto kosto janë llogaritur, shih Aneksin VI. Rezultatet e përcaktimit të koston janë përmbledhur më poshtë. Përfaqja e ndjekur në përcaktimin e koston dhe disa hamendësime të përgjithshme janë përshkruar në pjesët vijuese.

Të gjitha kostot janë llogaritur me çmimet konstante të vitit 2008.

4.1.3 Hamendësimet e bëra

Duhet bërë një sërë hamendësimesh në përcaktimin e kostove të tilla. Disa nga këto hamendësime trajtohen këtu. Hamendësime më të hollësishme të lidhura me veprimet specifike janë prezantuar së bashku me diskutimin mbi veprimin e veçantë.

Data e pranimit të Shqipërisë në BE

Një hamendësim duhet të bëhet në lidhje me datën pasi:

(a) në parim, Shqipëria duhet të respektojë kërkesat e direktivave të BE-së në datën e pranimit në BE (megjithëse në praktikë do të jetë në gjendje të negociojë një shtyrje për disa nga detyrimet e saj më të vështira / që kërkojnë më shumë kohë).

(b) statusi financiar i Shqipërisë do të ndryshojë kur të ajo të pranohet në BE. Do të ndalojë së qeni e kualifikuar për Instrumentin e BE-së për Asistencë Para-Pranimin (IAP) si edhe për asistencë nga shumica e donatorëve bilateralë, por nga ana tjetër do të kualifikohet për fonde nën fondet e kohesionit dhe ato shoqërore.

Data e pranimit të Shqipërisë në BE presupozohet të jetë 31 Dhjetor 2015.

Autoritetet Kompetente

Kompetencat për zbatimin e Direktivës mbi TUUN nuk janë përcaktuar ende zyrtarisht. Në alokimin e kostove ndaj institucione përkatëse është presupozuar se:

- MMPAU do të ketë përgjegjësinë definitive për të siguruar që Direktiva është zbatuar, për koordinimin dhe për të gjitha aspektet mjedisore të Direktivës;
- MPPTT do të jetë përgjegjëse për koordinimin e investimeve për infrastrukturën dhe për të përgatitur dhe përditësuar programin e zbatimit për investimet në infrastrukturë, dhe mundësisht për të mbajtur projekte në zhvillim;
- Bashkitë, megjithatë, do të jenë përgjegjëse të paktën eventualisht për të zbatuar këto investime, megjithëse për momentin ky është një funksion i MPPTT. Kjo është një konsekuencë llogjike e procesit të decentralizimit, dhe do të paralelizojë përgjegjësinë për investime me përgjegjësinë për ofrimin e shërbimeve sanitare, që janë pjesë e përgjegjësisë të bashkive.

Zonat Sensitive

Për momentin, as nuk janë elaboruar ende kriteret formale për shpalljen e zonave sensitive, dhe as nuk janë mbledhur të dhënat e nevojshme. Nuk dihet se çfarë proporcioni i Shqipërisë do të duhet të konsiderohet si sensitive në sensin e Direktivës. Siç u përmend në pjesën 3.4.2, presupozohet që për qëllim të përcaktimit të kostos të gjithë trupat ujorë me ujë sipërfaqësorë do të përcaktohen / shpallen si 'zona sensitive'. Një gjë e tillë ka vetëm një impakt të vogël në kostot kapitale, por rezulton në kosto operative më të larta (në veçanti përdorimi i energjisë).

Fazimi i masave dhe investimit

Direktiva mbi Trajtimin e Ujërave Urbanë të Ndotur është një nga direktivat më të kushtueshme në acquis-në mjedisore. Ne, ndërkohë, kemi parë kostot e larta të përfshira në ndërtimin dhe rinovimin e infrastrukturës (tabelat 8 dhe 9) dhe kemi diskutuar nevojën për ta shpërndarë këtë përpjekje për investim gjatë një periudhe kohore prej 18 vjetësh - propozuar në pjesën 3.4, me kushtin që do të jetë e nevojshme të shtyhet ose të zgjerohet afati kohor nëse duhet për arsye të financimit të kostove.

Megjithatë, duhet marrë në konsideratë se shtyrja e datës së fillimit ose zgjerimi i afatit kohor do të thotë që nuk do të jetë më i mundur praktikisht pranimi në BE në vitin 2015. Kjo për arsye se, është e pamundur që Komisioni Europian të bjerë dakord në negociimet për anëtarësim për një periudhë tranzicioni më të gjatë se 12 vjet. Kjo do të thotë se, nëse Shqipëria do të bashkohej me BE-në në vitin 2015, do të duhej të demonstronte zbatimin e plotë të Direktivës mbi TUUN deri në vitin 2027. Ky vit korrespondon me vitin relativ 0018 nëse zbatimi fillon në vitin 2010, duke e marrë këtë të fundit si vit relativ 0000.

4.1.4 Kostot e përlogaritura për transpozimin

Burimet për hartimet ligjore në MMPAU do të jenë nën presion në vitet e ardhshme, edhe në rast se kapacitetet rriten. Do të ishte me vend të merrej në konsideratë një projekt i asistencës teknike për të mbështetur Ministrinë në këtë punë. Detyra që duhet përbushur është përshkruar në pjesën 3.2. Është llogaritur që një projekt asistence teknike do të kushtonte rreth €300,000.

4.1.5 Kostot e përlogaritura për zbatimin

Zbatimi i Direktivës mbi Trajtimin e Ujërave Urbanë të Ndotur do të jetë kryesisht përgjegjësi e autoritetit kompetent të caktuar për të zbatuar Direktivën në nivel kombëtar (nuk është caktuar akoma formalisht, por presupozohet të jetë MMPAU) dhe e bashkive (mundësisht në disa raste të organizuara në shoqata për t'u fuqizuar financiarisht dhe për të reflektuar faktin që shpesh është avantazh nga pikëpamja ekonomike të ofrohen

shërbimet e kanalizimeve për komunitetet e grupuara). Këshillat e Basenëve të Lumenjve mund të luajnë rol në disa aktivitete zbatimi, për shembull në përcaktimin e standarteve të trajtimit dhe atyre të efluentëve (mbetjeve të lëngëta), monitorimin dhe inspektimin.

Kostot e përgjithshme të përlllogaritura për zbatimin e Direktivës tregohen në tabelën e mëposhtme:

Tabela 10: Kostot totale për zbatimin e Direktivës mbi TUUN, sipas agjencisë / sektorit përkatës

Agjenica / sektori përkatës	Kosto kapitale / që ndodhin vetëm një herë ⁵ (€000)	Kosto operative / që përsëriten (€000/y)
Qeveria Shqiptare	1,600	-
MMPAU	7,240	82
MPPTT	-	29
Agjencia Mjedisore	-	14
Bashkitë	2,377,782	49,683
Industria	37,500	1,875
Totali	2,424,122	51,683

Shihet qartë se zbatimi i Direktivës mbi Trajtimin e Ujërave Urbanë të Ndotur do të jetë shumë i kushtueshëm. Totali i kostove të zbatimit përbëhet nga kostot kapitale prej rreth €2,400 milionë dhe kostot operative të cilat arrijnë eventalisht në €52 milionë në vit. Kjo kosto totale është e barasvlefshme me rreth 10% të PBB vjetor. Kostot tregohen në tabelë sipas palës përgjegjëse kryesore për aktivitetin. Pjesa dërrmuese do të jetë përgjegjësi e bashkive. Kjo për shkak se sipas hamendësimeve të bëra do të jetë përgjegjësi e bashkive jo vetëm të shfrytëzojnë dhe mirëmbajnë infrastrukturën sanitare, por edhe të kryejnë investimin e kërkuar.

Kjo nuk do të thotë se bashkitë do të duhet t'i mbulojnë këto kosto nga burimet e tyre. Eventalisht kostot e rritura bashkiake do të rikuperohen nga përdoruesit e shërbimeve sanitare në formën e taksave më të larta për ujin / sanitetin. Në periudhën afatshkurtër deri afatmesme, kur këto kosto rriten ndjeshëm, bashkitë mund të parashikojnë të përftojnë mbështetje në formën e granteve dhe kredive të buta nga BE, IFN dhe ofruesit e tjerë të ndihmës bilaterale dhe multilaterale (shih 4.2).

Kostot e mësipërme ndahen si më poshtë:

⁵ Të gjitha kostot janë llogaritur me çmimet konstante të vitit 2008.

Tabela 11: Kostot e zbatimit të ndara sipas agjencisë / sektorit dhe tipit të veprimit

Agjencia/sektori / Tipi i veprimit	Kostot kapitale / që ndodhin vetëm njëherë ⁶ (€000)	Kostot operative / që përsëriten (€000/vit)	Shënime
Qeveria Shqiptare			
Asistencë teknike	1,600	-	Një projekt për të mbështetur qeverinë me fillimin e zbatimit: caktimi i autoriteteve kompetente, ngritja e procedurave
MMPAU (përfshirë Inspektoratin)			
Personeli shtesë		58	3 persona në MMPAU, 1 në Inspektorat. Përfshin kostot sociale dhe kostot përkatëse të punësimit: hapësirën për zyra, ngrohjen, paisjet normale, raportimin, shpenzimet e përgjithshme.
Paisje	10		Paisje dhe programe kompjuterike (Software dhe hardware) për bazë të dhënash dhe SIGJ
Asistencë teknike	7,200		Një projekt AT do të ofrojë mbështetje për autoritetet kompetente në aktivitetet kryesore (Plani Kombëtar për Administrimin e Ujërave të Ndotur)
Trajnim	30		Vini re se këtu nuk përfshihen të gjitha trajnimet, projektet e AT përfshijnë elementët kryesore të trajnimeve
Monitorimi dhe analiza		20	
Raportimi		5	Mbështetje për kërkesat e raportimit (Komisioni Publik Shqiptar)
MPPTT			
Personeli shtesë		29	2 persona: përfshin kostot sociale dhe kostot e lidhura me punësimin: zyra, ngrohja, paisjet normale, raportimin, shpenzime të përgjithshme.
Agjencia Mjedimore / Këshillat e Basenëve të Lumenjve			
Personeli shtesë		14	1 person shtesë, i cili do të kujdeset pas marrjes së lejeve / autorizimeve paraprake për shkarkimet industriale në kanalet e ujërave të zeza dhe shkarkimet nga kompanitë më të vogla në ujërat sipërfaqësorë
Bashkitë			
Personeli shtesë		2,822	196 persona shtesë (1 person për secilin aglomerat)
Studimet e Fizibilitetit, VIM, aplikimet për	16,652		

6 Të gjitha kostot janë llogaritur me çmimet konstate të vitit 2008.

financim			
Projektimi, ndërtimi dhe shfrytëzimi i infrastrukturës bashkiake	2,361,130	46,860	
Industria			
Paratrajtimi i ujërave të ndotur të shkarkuar në kanalet e ujërave të zeza	7,500	375	Bazuar tek standartet ose autorizimet paraprake. Kjo përfshon kompanitë që janë subjekt i PKIN.
Trajtimi i ujërave të ndotur të shkarkuar në ujërat sipërfaqësorë	30,000	1,500	Bazuar tek standartet ose autorizimet paraprake. Kjo përfshon kompanitë që janë subjekt i PKIN.
Totali	2,424,122	51,683	

Ose, përse i përket tipit të shpenzimeve vetëm:

Tabela 12: Kostot e zbatimit të ndara sipas tipit të veprimit

Tipi i veprimit	Kostot kapitale / që ndodhin vetëm njëherë ⁷ (€000)	Kostot operative / që përsëriten (€000/vit)
Studime fizibiliteti dhe aplikimet për financim	16,652	
Projektimi, ndërtimi dhe shfrytëzimi i infrastrukturës bashkiake:		
Etapa 1;	1,279,941	31,954
Etapa 2;	588,501	8,559
Etapa 3;	492,688	6,347
Totali	2,361,130	46,860
Trajtimi dhe paratrajtimi për ujërat industrialë të ndotur	37,500	1,875
Personeli shtesë		2,923
Asistencë teknike dhe trajnime	8,830	
Paisje të ndryshme	10	
Monitorimi dhe analiza		20
Raportimi		5
Totali	2,424,122	51,683

Vihet re që kostot dominuese janë ato të projektimit, ndërtimit dhe shfrytëzimit të infrastrukturës së re. Këto kosto përbëjnë 97% të kostove kapitale / që ndodhin vetëm një herë dhe 91% të kostove operative / që përsëriten. Studimet e fizibilitetit dhe aplikimet për financim

Do të duhen mbi 200 persona të rinj (ose ekuivalentët në persona) për të zbatuar Direktivën mbi TUUN, pjesa dërrmuese e të cilëve në nivel vendor, duke reflektuar në këtë mënyrë politikën decentralizuese të qeverisë dhe rolin në rritje që do të luajë pushteti vendor për sa i përket shërbimeve të sanitetit. Kjo shifër nuk përfshin personat e angazhuar në shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së re. Kostot që lidhen me rrogat e tyre

⁷ Të gjitha kostot janë llogaritur me çmimet konstate të vitit 2008.

përbëjnë një pjesë të kostove operative të strukturave, të përfshira tek shifrat e mësipërme.

Asistenca teknike totale do të kapë shifrën prej afërsisht €9 milionë, duke përjashtuar studimet e fizibilitetit.

Profili i kostove të shpërndara në kohë, p.sh. sipas viteve në të cilat ato ndodhin, jepet në tabelën që vijon.


Tabela 13: Kostot e zbatimit sipas viteve relative

Viti Relativ	Kosto Kapitale / që ndodhin vetëm një herë ⁸ (milionë €)	Kosto Operative / që përsëriten (milionë €/vit)
0	1	0
1	4	1
2	26	1
3	135	4
4	135	7
5	147	11
6	146	15
7	146	19
8	135	22
9	154	26
10	216	31
11	216	35
12	216	40
13	109	42
14	193	45
15	192	48
16	84	49
17	84	50
18	84	52

Kostot përsëritëse vazhdojnë të rriten gradualisht derisa Direktiva të zbatohet plotësisht.


Ecuria e kostove kapitale në kohë tregohet në grafikun e mëposhtëm.

⁸ Të gjitha kostot janë llogaritur me çmimet konstante të vitit 2008.



Kostot kapitale arrijnë maksimumin gjatë viteve 10 deri 12. Në secilin prej këtyre tre viteve, shpenzimet kapitale e tejkalojnë shumën 200 milionë Euro.

Diagrama e mëposhtme tregon ecurinë e daljes totale të parasë, p.sh. shuma e kostove kapitale dhe kostove përsëritëse në kohë.



Mund të shihet se kostot fillimisht dominohen nga kostot kapitale, por kostot përsëritëse gradualisht fillojnë të rriten dhe zenë një vend të konsiderueshëm. Kur të ketë përfunduar zbatimi në vitin 18, komponenti kapital zhduket (mos të harrojmë që shifrat nuk përfshijnë investimet zëvendësuese) dhe kostot vjetore nuk rriten më e fillojnë të stabilizohen.

4.2 Strategjia e Financimit

4.2.1 Hyrje

Qëllimi i kësaj pjese është të shohë se si mund të identifikohen kostot e identifikuar në pjesët e mëparshme.

Pika e nisjes në alokimin e kostove të Direktivës mbi Trajtimin e Ujërave Urbanë të Ndotur në të ardhmen është parimi kush ndot paguan. Ky parim bashkë me parimin e rikuperimit të plotë të kostos nga përdoruesit e sistemit është mbrojtur në ligjin e BE-se mbi ujin (për shembull shih Nenin 9 të Ligjit Kuadër mbi Ujin). Megjithatë, përveç të qenit një kërkesë ligjore, ky është një parakusht për fizibilitetin financiar afatgjatë dhe qëndrueshmërinë e sektorit të ujit dhe sanitetit, dhe do të ofrojë gjithashtu një shtysë në rritje për prodhuesit e mbetjeve që të reduktojnë sasinë e ujit të konsumuar.

Parimi Kush Ndot Paguan (KNP) do të thotë se prodhuesit e ujërave të ndotur duhet të paguajnë koston e plotë të grumbullimit dhe trajtimit të këtyre ujërave të ndotur. Megjithatë, në përpjekje e sipër për të aplikuar këtë parim të qartë, pikat e mëposhtme praktike duhet të mbahen në mendje:

- Zbatimi i Direktivës përfshin kosto të larta siç mund të shihen më sipër dhe prandaj do të nënkuptojë rritje të konsiderueshme të tarifave për përdoruesit e ujit. Rrjedhimisht lindin pyetjet e përballueshmërisë dhe të rregullimit të rritjeve të çmimit;
- Zërat madhorë të shpenzimeve kapitale janë përfshirë; këto zëra do të duhet të financohen, edhe në rast se kostoja e këtij financimi do të përballohet eventualisht nga prodhuesit e mbetjeve;
- Lind pyetja se ç'pjesë e kostos që lidhet me administratën publike e cila merret me administrimin e ujërave të ndotur do të duhet të paguhet nga fondet publike dhe ç'pjesë e saj do të paguhet nga ndotësi. Kjo do të jetë një çështje që adresohet në Veprimin Nr. 3 (shih Tabelën 5).

4.2.2 Burimet e financimit – Të përgjithshëm

Burimet kryesore të mundshme për financim janë:

- prodhuesit e ujërave të ndotur (matjet kryhen nga ata vetë);
- tarifatat e paguara nga prodhuesit e ujërave të ndotur tek administratorët e ujërave të ndotur;
- tarifatat ose taksat mbi produktet e reja që synojnë të paguajnë kostot e depozitimit / asgjësimit përfundimtar;
- buxheti shtetëror ose bashkiak;
- fondi mjedisor
- grantet nga instrumenti i asistencës para-pranimit në BE (IAP);
- grantet nga Fondi European për Zhvillim Rajonal (FEZHR) – Pas-Pranimit
- grante nga donatorë të tjerë ndërkombëtarë;
- kredi nga institucione financiare ndërkombëtare;
- kredi nga institucione financiare bilaterale;
- kredi nga bankat tregtare;

- bonot e emetuara nga autoritetet e pushteti qendror ose vendor;
- kapitali privat (nëpërmjet organizimeve PPP).

Ne po marrim në konsideratë burimet e ndryshme të mëposhtme:

Prodhuesit e mbetjeve (matjet kryhen nga ata vetë)

Për shembull prodhuesit e ujërave të ndotura në komunitetet e vogla të largëta të cilët nuk janë të lidhur me sistemin publik të kanalizimeve do të mbulojnë kostot e rezervuarëve septikë ose të masave të tjera të ndërmarra në lidhje me ujërat e tyre të ndotur.

Tarifat e paguara nga prodhuesit e ujërave të ndotur tek administratorët e ujërave të ndotur

Këto do të jenë kryesisht tarifa për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotur. Prodhuesit e ujërave të ndotur tashmë i paguajnë tarifa të tilla kompanive lokale të shërbimeve, por ka të ngjarë që këto tarifa të rriten në mënyrë që të reflektojnë kostot e respektimit të kërkesave të legjislacionit të BE-së, dhe më shumë njerëz do t'i paguajnë ato në të ardhmen pasi do të rritet shkalla e mbulimit me sisteme kanalizimesh.

Buxheti shtetëror ose bashkiak

Për momentin nuk ka asnjë financim nga buxhetet bashkiake, edhe pse bashkitë tani janë pronare të pothuaj të gjitha kompanive të shërbimeve. Kjo situatë nuk ka të ngjarë që të ndryshojë në të ardhmen. Kompanitë e shërbimeve po bëjnë përpjekje që të jenë të vetë-qendrueshme nga ana financiare dhe, derisa të realizohet një gjë e tillë, është e pamundur që ato të marrin përsipër përgjegjësi financiare për shërbimet.

Buxheti i shtetit, nga ana tjetër, aktualisht është duke kryer dy lloj kontributesh në sektor:

1. U paguan një subvencionim kompanive të ujit të cilat nuk mbulojnë kostot e tyre (p.sh. pjesa më e madhe e kompanive), të barabartë me defiçitin e tyre. Subvencionimi operativ total i paguar në vitin 2008 ishte afërsisht 1.4 miliardë (1400 milionë) lekë (rreth €11 milionë) (Të dhënat janë marrë nga baza e të dhënave referencë nga DPUK). Kjo padyshim që mbulon si ujësjellësin dhe sanitetin.
2. Pagan një shumë në llogarinë kapitale si një kontribut për kostot e rinovimit të infrastrukturës ekzistuese, ose ngritjes së infrastrukturës së re. Shuma e paguar në vitin 2008 ishte afërsisht 7.5 miliardë lekë (rreth €60 milionë). Kjo mbulon si ujësjellësin dhe sanitetin.

Duket e arsyeshme të presupozohet: që defiçiti do të reduktohet me 10% në vit (në mënyrë lineare) gjatë 10 viteve të ardhshme, që qeveria do të rrisë shpenzimet e saj totale në sektorin e ujit me 3% në vit, dhe që kursimet nga subvencionimet operative do të kalojnë në llogarinë e investimeve.

Së fundmi, duket e arsyeshme të presupozohet që 50% e kontributit total të qeverisë që shkon në sektorin e ujit dhe sanitetit do të financojë specifikisht projekte për ujërat e ndotur. Në të kaluarën, kjo shifër ka qenë më e ulët, pasi reflektonte përparësinë më të madhe që kishte furnizimi me ujë ndaj trajtimit të ujërave të ndotur. Megjithatë, ne presupozojmë që kjo përqindje do të rritet siç është treguar këtu me qëllim që të reflektojë nevojën për të bërë progres në zbatimin e Direktivës mbi TUUN.

Kontributi drejt mbulimit të kostove për investimet e ardhshme nga buxheti i shtetit në bazë të hamendësimeve është dhënë në tabelën e mëposhtme.

Tabela 14: Llogaritja e fondeve që mund të jenë të vlefshme nga buxheti i shtetit në vitet e ardhshme për investime në infrastrukturën e ujërave të ndotur (në € milionë)

Viti	Fondet totale nga buxheti i shtetit	Subvencionimet operative	Investimet per projektet e ujit dhe sanitetit	Investimet vetëm për projektet e sanitetit
2008	71.0	11.0	60.0	30.0
2009	73.1	9.9	63.2	31.6
2010	75.3	8.8	66.5	33.3
2011	77.6	7.7	69.9	34.9
2012	79.9	6.6	73.3	36.7
2013	82.3	5.5	76.8	38.4
2014	84.8	4.4	80.4	40.2
2015	87.3	3.3	84.0	42.0
2016	89.9	2.2	87.7	43.9
2017	92.6	1.1	91.5	45.8
2018	95.4	0.0	95.4	47.7
2019	98.3	0.0	98.3	49.1
2020	101.2	0.0	101.2	50.6
2021	104.3	0.0	104.3	52.1
2022	107.4	0.0	107.4	53.7
2023	110.6	0.0	110.6	55.3
2024	113.9	0.0	113.9	57.0
2025	117.4	0.0	117.4	58.7

Megjithatë, eventualisht, shteti do të jetë në gjendje të ndalojë së kontribuari në kostot kapitale në sektorin e ujit, pasi përfundimisht ky sektor do të jetë i vetë-qendrueshëm dhe në gjendje të krijojë një fond rezervë për investime të ardhshme ose të përftojë financime në qarkun tregtar.

Fondi mjedisor

Fondi mjedisor është një fond i përbërë nga të ardhurat e taksave ose tarifave specifike. Këto taksa ose tarifa, mund, për shembull, të vilen për prodhimin ose importimin e produkteve specifike të cilat krijojnë rryma mbetjesh të mëdha dhe problematike. Kjo gjë në parim, mund të përdoret për të financuar infrastrukturën e sanitetit, për shembull. Këto lloj fondesh kanë rezultuar shumë të dobishme në vendet e tjera të Europës Lindore.

Aktualisht, në Shqipëri nuk ka asnjë fond specifik mjedisor. Ministria e Financave ka qenë kundër idesë për një fond mjedisor, duke argumentuar se fondi deformon alokimin e burimeve.

Instrument për Asistencën Para-Pranimin (IAP)

IAP është prezantuar në Janar 2007, dhe zëvendëson programe të ndryshme të mëparshme të BE si APHRE, IPSP, PSHBZHR dhe AKRZS si dhe instrumentat financiarë për vendet kandidate dhe vendet potenciale për t'u bërë kandidate.

IAP është i përbërë nga pesë komponentë të ndryshëm:

- I. Asistencë për tranzicionin dhe ngritjen institucionale
- II. Bashkëpunim ndërkufitar (me Shtetet Anëtare të BE dhe me shtete të tjera të kualifikuara (që gëzojnë të drejtën) për IAP);
- III. Zhvillim rajonal (transporti, zhvillimi ekonomik dhe mjedisor);
- IV. Burime njerëzore (fuqizimi i kapitalit njerëzor dhe të luftuarit e mospërfshirjes së të gjithë njerëzve);
- V. Zhvillimi rural.

Komponenti I është nën përgjegjësinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Komisionit për Zgjerimin, i cili është gjithashtu përgjegjës për koordinimin në tërësi të asistencës para pranimit (në BE). Ky komponent përfshin masat për ngritjen institucionale dhe investimet e lidhura me to, si edhe masat për tranzicion dhe stabilizim kur ato janë të nevojshme. Asistenca lëvrohet nëpërmjet programeve vjetore kombëtare dhe me përfitues të shumtë.

Komponenti II mbështet bashkëpunimin ndërkufitar në kufijtë midis vendeve kandidate / dhe atyre që janë potenciale për t'u bërë kandidate, si dhe ndërmjet tyre dhe vendeve të BE. DP për Zgjerimin dhe Drejtoria e Përgjithshme e Komisionit për Zhvillim Rajonal janë përgjegjëse së bashku për zbatimin e komponentit II. Kërkohej një aplikim i përbashkët me vendin fqinj.

'Vendet potenciale për t'u bërë kandidate' siç është Shqipëria gëzojnë të drejtën të përfitojnë vetëm nga komponentët I dhe II të sipërpërmendur.

BE alokon fonde treguese shumë vjeçare duke iu referuar Kuadrit Financiar Shumë Vjeçar KFSHV të IAP. Të dhënat për Shqipërinë janë siç vijojnë:

Tabela 15: Alokimet treguese të IAPnë Shqipëri

Viti	Komponenti I (milionë €)	Komponenti II (milionë €)	Totali (milionë €)
2007	54.3	6.7	61.0
2008	61.1	9.6	70.7
2009	70.9	10.3	81.2
2010	82.7	10.5	92.3
2011	?	?	98.7

Shumat e disponueshme në të ardhmen do të rriten ngadalë në terma realë pas vitit 2011, deri në datën e pranimit (në BE). Kur Shqipëria të bëhet kandidate me të drejta të plota, do të ketë gjithashtu një rritje të alokimeve treguese.

Këto shuma mbulojnë ndihma për të gjithë sektorët dhe jo vetëm për sektorin mjedisor apo atë të mbetjeve. Projektet janë klasifikuar si detyrime anëtarësie, politike dhe ekonomike. Ndarja e fondeve të alokuara sipas grupeve nga viti 2007 deri në vitin 2009 ishte respektivisht 30-35%, 20-25% dhe 40-50%. Asistenca për zbatimin e Direktivës mbi Mbetjet e Ujërave Urbanë të Ndotur duhet të klasifikohet si një detyrim anëtarësie.

Duhet theksuar se alokimi për vitin 2007 është aktualisht duke pritur aprovimin përfundimtar të BE-së, aprovimi për alokimin e vitit 2008 është deri diku larg, dhe alokimi për vitin 2009 aktualisht është ende duke u programuar. Projektet e reja nuk do të jenë të kualifikuar para IAP 2010, i cili nuk do të fillojë disbursimin para vitit 2011.

Duke filluar me alokimin e fondeve të IAP 2008, pritet që Shqipëria të sigurojë bashkëfinancimin – nga 10% për projektin e AT deri në 25% për projektet për investime. Megjithatë në rastin e mëparshëm ky bashkëfinancim mund të jetë ‘në natyrë’ më tepër sesa domosdoshmërisht një kontribut monetar. Duke qenë se një gjë e tillë mund të përfshijë pagat e homologëve pjesëmarrës nga shërbimet publike, dhe duke qenë se një pjesëmarrje e tillë është në çdo rast e dëshirueshme e në të vërtetë e nevojshme në projektin e AT, supozohet që kostot bashkëfinancuese të Shqipërisë do të jenë pothuajse zero.

Grantet nga Fondi European për Zhvillim Rajonal FEZHR dhe FK

Kur Shqipëria të bashkohet aktualisht me BE-në, do të ketë mundësinë që të aplikojë për fonde në Fondin për Zhvillim Rajonal dhe në Fondin e Kohezionit. Deri tani nuk dihet se sa do të jenë fondet e disponueshme, por duke u bazuar në eksperincën e vendeve që hynë në BE në vitin 2004 dhe në eksperincën e Rumanisë dhe Bullgarisë, ka gjasa që të ketë fonde shumë më të mëdha se fondet e para-pranimit, për të ndihmuar Shqipërinë që të ketë një infrastrukturë sipas standarteve të BE-së. Për shembull, për SHRA -10 fondet u rritën nga 0.75% të PBB para-pranimit, në 3.5% për periudhën 2004-2006 dhe 3.9% për periudhën 2007-2013. Do të kërkohen edhe disa bashkëfinancime nga Shqipëria, por ndërkohë janë përcaktuar kushtet për këto bashkëfinancime.

Ndihma të tjera bilaterale dhe multilaterale

Sipas bazës së të dhënave mbi projektet, të mbajtur nga njësia e koordinimit të donatorëve të huaj brenda Këshillit të Ministrave, donatorët që nuk janë pjesë e BE-së kanë angazhuar si ndihmë shuma deri në 2600 milionë Euro gjatë viteve 2000 - 2008. Kjo gjë arriti pikun me rreth 470 milionë Euro në vitin 2005, dhe më pas ka ardhur gradualisht duke u zvogëluar. Nga ky total, një shumë prej 280 milionë Euro ishte specifikisht për projektet në sektorin e ujit (kryesisht furnizimin me ujë dhe sanitetin), nga të cilat 100 milionë Euro si grant dhe 180 milionë Euro si kredi, dhe një shumë tjetër prej 86 milionë Euro (e alokuar në 4 vitet e fundit, nga të cilat 65 milionë Euro si grant) ishte për projekte të tjera në sektorin mjedisor. Qeveritë dhe institucionet kryesore donatore gjatë kësaj periudhe kanë qenë: BE-ja, Gjermania, Italia, Austria, Holanda. Qeveria duhet të bëjë përpjekje në mënyrë që të sigurojë sa më shumë fonde ndihmë që të jetë e mundur për Shqipërinë të cilat do të kontribuojnë në plotësimin e detyrimeve për t'u anëtarësuar në BE.

Kreditë nga institucionet financiare ndërkombëtare (IFN)

Institucionet financiare ndërkombëtare janë bankat e zhvillimit, siç është Banka Botërore, Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Banka Europiane për Investime (BEI) të cilat ofrojnë kredi me normë të ulët interesi për investime (ndërmjet të tjerave) me synimin për të ngritur ose përmirësuar strukturat mjedisore ose infrastrukturën.

Banka Botërore ka publikuar Strategjinë për Asistencë në Vend në Janar 2006 (që mbulonte periudhën kohore 2006 deri 2009), në të cilën bëhet e

ditur rëndësia e Procesit të Stabilizim Asociimit të Shqipërisë, dhe përmendet në mënyrë specifike aksesit i përmirësuar në furnizimin me ujë sigurt dhe sanitetin në zonat rurale, si pjesë përbërëse e një prej dy shtyllave në të cilat është fokusuar programi. Shqipëria tani është klasifikuar plotësisht për anëtarësim tek BNRZH (IBRD), kështu që nuk kualifikohet më për financime konçesionare nga ANZH (IDA). Vitet e fundit Banka është përfshirë në një numër projektesh të rëndësishme për furnizimin me ujë dhe sanitetin, dhe gjithashtu ka ofruar konsulencë për qeverinë për çështje të ndryshme që lidhen me reformat dhe decentralizimin në sektorin e ujit. Banka është shumë e interesuar për investime në sektorin e ujit. Një strategji e re për asistencën në vend do të hartohet më vonë këtë vit. Nuk ekziston ndonjë limit specifik për fondet që do të vihen në dispozicion nga Banka, një gjë e tillë varet nga fakti se sa i plotësojnë kriteret e Bankës projektet dhe cilat janë limitet e huamarrjes së vetë Shqipërisë. Zakonisht, kreditë kanë një normë interesi LIBOR + 0.25 deri në 0.5%

BERZH është investitori i vetëm më i madh në Europën Qendrore dhe Lindore. Në ndryshim nga Banka Botërore, BERZH i jep hua si klientëve publikë, ashtu edhe atyre privatë. Megjithatë pritet që korporatat të kenë objektiva të përcaktuara qartë, struktura administrimi dhe vendim-marrjeje, dhe të operojnë përgjatë linjave tregtare. Do të preferohej më shumë që për infrastrukturën bashkiake t'i jepej hua një huamarrësi vendor (bashki, kompani shërbimi) sesa qeverisë qendrore. Nga ana tjetër, aktualisht Banka do të merrte në konsideratë vetëm një kredi për infrastrukturën në nivelin e Tiranës, për shkak se ajo plotëson kriteret e saj për të qenë e pranueshme nga ana bankare. Nuk është domosdoshmërisht e nevojshme një garanci absolute. BERZH është e predispozuar që të japë hua me norma interesi më të larta se ato të Bankës Botërore (për shembull LIBOR + 2 deri në 4%).

Një aktor i rëndësishëm në Shqipëri është KfW (Banka Gjermane për Zhvillim, Instituti i Kredive për Rindërtim). KfW është një bankë zhvillimi, të cilën e zotëron qeveria Gjermane dhe Länder, dhe është shumë aktive në sektorin e mbetjeve në Shqipëri. Deri tani qeveria Gjermane ka angazhuar 140 milionë Euro për projektet në sektorin e ujit dhe sanitetit në Shqipëri, dhe janë në proces projekte të financuara nga KfW në 9 qytete, si dhe një projekt për furnizimin e ujit në zonat rurale. Banka ka qenë aktive dhe në këshillimin e qeverisë Shqiptare për reformën në sektorin e ujit. Financimi mund të bëhet i disponueshëm nga konsultimi midis qeverisë Gjermane dhe Ministrisë Shqiptare të Financave sipas termave të favorshme. Nuk ekziston ndonjë limit specifik i përcaktuar nga ana Gjermane për shumën që do të jepet hua, kështu që propozimet duhen gjykuar sipas avantazheve të tyre specifike.

Institucionet zakonisht preferojnë që të mos japin hua shuma më të vogla se sa një vlerë e caktuar. Këto kufizime kanë si predispozitë të kufizojnë mundësinë e pjesëmarrjes së IFN në financimin e investimeve kapitale të projekteve me madhësi pothuaj të konsiderueshme. Përveç kësaj, për të negociuar dhe për të marrë një kredi nga IFN, nevojiten burime të rëndësishme dhe kohë.

Kreditë nga bankat tregtare

Autoritetet vendore kanë mundësi që të marrin kredi nga bankat tregtare, por kushtet janë më pak të favorshme se ato të institucioneve financiare

ndërkombëtare dhe bilaterale. Jo vetëm që norma e interesit ka gjasa të jetë më e lartë, por edhe afati i shlyerjes së kredisë ka mundësi të jetë më i shkurtër, dhe ndoshta mund të mos ketë periudhë faljeje (periudhë gjatë të cilës paguhen vetëm interes).

Bonot e emetuara nga autoritetet e qeverisjes vendore

Procesi i decentralizimit nuk ka përfunduar ende dhe autoritetet e pushtetit vendor nuk janë ende në një fazë të tillë që të mund të parashikojnë emetimin e bonove si një mjet për të rritur financat. Kjo për shkak të përmasave të vogla të tyre, mungesës së auditimit të pavarur të llogarive të tyre, cilësisë së dobët të të dhënave financiare, nevojës për të përfutur një normë kredie nga organizata siç janë Standard & Poor, Moody's, etj.

Kapitali privat (nëpërmjet organizimeve PPP).

Në një etapë të mëvonshme gjatë periudhës në fjalë mund të jetë e mundur thithja e kapitalit privat për disa projekte në infrastrukturën mjedisore. Nga njëra anë e spektrit, bashkitë mund të realizojnë një kontratë shërbimi me një kompani private për shfrytëzimin e strukturave të ujësjellësit dhe / ose ato të kanalizimeve për një periudhë të specifikuar kohore në këmbim të një tarife. Në një nivel më të sofistikuar, kontraktuesit privatë mund të shfrytëzojnë, për shembull një impiant për trajtimin e ujërave të ndotur të një aglomerati, në formën e një konçensionit ose nën një kontratë NSHT (ndërto - shfrytëzo - transfero). Kjo shmang problemet financiare për qeverinë, duke qenë se është një kompani private ajo që siguron financat e nevojshme, dhe në parim tarifa mund të rikuperohet nga taksat që u vihen prodhuesve të mbetjeve. Struktura të tilla do të kërkojnë një sërë zhvillimesh përpara se ato të mund të vizualizohen në Shqipëri, duke përfshirë reformën në departamentin e kontabilitetit / llogarimbajtjes në ndërmarrjet komunale dhe të shërbimeve, dëshmi e qartë kjo, se shteti është i gatshëm për të vënë në zbatim standartet, se bashkitë janë të gatshme të lejojnë faturimin e kostove të plota tek përdoruesit e ujit, dhe që këta të fundit do të kenë mundësi t'i paguajnë ato, si edhe e shfaqjes së operatorëve të gatshëm dhe të besueshëm për strukturat e reja.

Të ardhura të tjera të ndryshme

Spektori i ujërave dhe sanitetit gjeneron një sërë të ardhurash të tjera, p.sh. të ardhurash nga tarifat për autorizimet e lëshuara në bazë të Neneve 11 dhe 13 të Direktivës TUUN, dhe gjobave të vëna për shkeljet e rregulloreve ose standarteve. Për sa i përket tarifave, është plotësisht e arsyeshme, dhe nën frymën e parimit kush ndot paguan, që tarifat të vendosen në një nivel të tillë që të rikuperohen kostot për shfrytëzimin e sistemit të lejuar. Në lidhje me gjobat, destinacioni i tyre do të varet nga mënyra se si janë shkruar sanksionet në ligj. Mund të mos jetë ligjërish e mundur që në këtë sektor të riciklohen të ardhura të tilla.

4.2.3 Financimi i kostove

Tani do të marrim në konsideratë si do të financohen në të ardhmen komponentë të ndryshëm të shpenzimeve kapitale dhe operative. Kemi vënë re se kostoja kapitale totale e përlogaritur për zbatimin e DUUN në Shqipëri është 2.4 miliardë Euro, që është e barasvlefshme afërsisht me 670 Euro për banor. Financimi i një shpenzimi të tillë do të jetë një sfidë shumë e madhe. Do të jetë e rëndësishme që Shqipëria të mobilizojë sa më shumë financime që të jetë e mundur në formën e granteve ndihmë.

Kostot për të cilat janë përgjegjës pushteti qendror, pushteti vendor dhe industria janë shqyrtuar në mënyrë të veçantë.

Kostot për të cilat është përgjegjës pushteti qendror

Është e nevojshme që të bëhet një dallim midis kostove të vazhdueshme, që përsëriten dhe kostove që ndodhin vetëm një herë, të cilat lidhen me zbatimin e Direktivës.

Kostot e para lidhen kryesisht me pagat, kostot e personelit dhe kostot operative të sistemeve të reja, dhe në parim këto do të duhet të mbulohen nga buxheti i shtetit.

Kostot që ndodhin vetëm një herë lidhen me asistencën teknike, trajnimet, artikujt e vegjël të paisjeve dhe blerjen e paisjeve dhe programeve kompjuterike (hardware dhe software). Autoritetet duhet të kërkojnë që t'i financojnë këto shpenzime nga grantet ndihma të dhëna nga IAP dhe donatorë të tjerë ndërkombëtarë.

Në bazë të kësaj kemi:

Tabela16: Burimet e financimit të kostove për të cilat është përgjegjës pushteti qendror

Agjencia/të	Shuma (€000s)	Lloji	Burimi i fondit
Qeveria Shqiptare, MMPAU, MPPTT, Agjencia mjedisore*	8840	Kostot që ndodhin vetëm një herë - AT dhe trajnimi	IAP (komponentët I dhe IV), donatorë të tjerë bilateralë ose multilateralë
	126 (n. v.)	Kosto që përsëriten, kryesisht pagat, por edhe monitorimi, raportimi	Buxheti i shtetit

*Ose këshillat e basenëve të lumenjve, në varësi faktit se kush e ka përgjegjësinë për autorizimin paraprak për shkarkimet industriale

Kostot për të cilat do të jenë përgjegjëse bashkitë/kompanitë që ofrojnë shërbimet e ujësjellësit

Këto janë kostot që lidhen me investimin ose shfrytëzimin e sistemeve të ujësjellësit dhe sanitetit, dhe të mbikqyrjes së tyre. Megjithatë, për momentin, në fund të fundit kjo është përgjegjësi e MPPTT, këto përgjegjësi do t'i kalojnë bashkive me kalimin e kohës si pjesë e decentralizimit të pushtetit dhe reformës në sektorin e ujrave.

Në këtë zë nuk është përfshirë asnjë asistencë teknike ose trajnim, sepse kostot e trajnimit fillestar për bashkitë lidhur me përgjegjësitë e tyre të reja

janë trajtuar si përgjegjësi e pushtetit qendror, dhe janë përfshirë në tabelën e mëparshme.

Për sa i përket kostove që lidhen me infrastrukturën e sanitetit, ato janë shqetësuese. Lindin dy pyetje në lidhje me këto çështje, p.sh. si do të financohet kapitali ? dhe kush do të paguajë për kostot operative dhe kostot e shërbimit të financimit (shlyerjes së financimit)? Këtyre pyetjeve u jepet përgjigje në Tabelën e mëposhtme.

Pagat shtesë dhe kostot e lidhura me pagat shkojnë deri në 6.3 milion Euro në vit. Këto mund të ngarkohen në buxhetet e përgjithshme të bashkive, por legjislacioni i BE-së duket se inkurajon që këto kosto të rikuperohen gjithashtu nga tarifat e vjelura nga konsumatorët e ujit.

Ashtu si në rastin e shpenzimeve të qeverisjes qendrore, kostot për të dhënë asistencë teknike dhe trajnime për bashkitë duhet të financohen nga mekanizmat e duhur të IAP dhe financimet nga agjensitë e tjera donatore.

Tabela 17: Burimet e financimit për shpenzimet për të cilat janë përgjegjëse bashkitë

Zëri (nga tabela 8)	Shuma (€000s)	Kapitali i financuar nga:	Eventualisht paguhen nga:
Studimet e fizibilitetit/aplikimet për financim	16,652	IAP (komponentët I dhe IV) ose donatorë të tjerë bilateralë ose multilateral	BE ose donatorë të tjerë
Kostot kapitale për infrastrukturën e sanitetit	2,361,130	Buxheti i shtetit siç tregohet në tabelën 14, fillimisht. Megjithatë Pjesa tjetër nga burimet e mëposhtme në rend zbritës preference: <ul style="list-style-type: none"> • IAP ose fonde të tjera grant (para-pranimi) ose Fondet e Zhvillimit Rajonal / Kohezionit (pas-pranimi) • Kredi nga Banka Botërore ose IFN të tjera • Bankat tregtare Duhet marrë parasysh gjithashtu thithja e kapitalit nga sektori privat, për shembull nëpërmjet N.SH.T. ose mënyrave të ngjashme	Përdoruesit e ujit /gjeneruesit e ujërave të ndotur
Kostot operative të infrastrukturës së sanitetit	46,860 (n. v)	P.A.	Përdoruesit e ujit / gjeneruesit e ujërave të ndotur nëpërmjet tarifave për ujin dhe sanitetin (subvencionime nga buxheti i shteti të shtrira në kohë sipas mundësive)

Pagat e personelit shtesë të bashkisë	2,822 (n.v.)	P.A.	Përdoruesit e ujit / gjeneruesit e ujërave të ndotur nëpërmjet tarifave për ujin dhe sanitetin ose buxhetet e përgjithshme të bashkive
---------------------------------------	-----------------	------	--

Sigurisht që sfida më e madhe do të jetë rritja e kapitalit për infrastrukturën e sanitetit. Kjo sfidë do të jetë veçanërisht e dukshme në vitet para-pranimit, përpara se të bëhet i disponueshëm financimi i madh në formë granti nën instrumentat pas-pranimit.

Nëse, për hir të argumentit, presupozojmë se Shqipëria do të pranohet në BE në vitin 2015, atëherë bilanci i financimit për periudhën para-pranimit (deri në vitin 2015, duke e përfshirë edhe 2015) është përlogaritur në tabelën që vijon:

Hamendësimet në përcaktimin kohor	Kapitali i kërkuar deri në datën e pranimit (milionë€)	Financa të disponueshme nga:	
Viti relativ 0 = 2010	552	të angazhuara ndërkohë	106
		buxheti i shtetit	226
		IAP	59
		donatorë të tjerë	30
		boshllëku i financimit	<u>131</u>
		totali	552
Viti relativ 0 = 2011	420	të angazhuara ndërkohë	106
		buxheti i shtetit	192
		IAP	50
		donatorë të tjerë	25
		boshllëku i financimit	<u>47</u>
		totali	420

Kostot sipas datës së supozuar të pranimit në vitin 2015 varen nga fakti se kur do të fillojë realisht zbatimi. Më sipër janë marrë në konsideratë dy situata, të quajtura viti relativ 0 = 2010 (që do të thotë se zbatimi fillon në 2010) ose viti relativ 0 = 2011 (që do të thotë se zbatimi fillon në 2011).

Financat e angazhuara ndërkohë i referohen projekteve të cilat kanë filluar tashmë ose janë mirë planifikuar dhe ku është bërë tashmë angazhimi financiar (p.sh. Durrësi, Saranda, Vlora, Tirana).

Shifrat për buxhetin e shtetit kanë dalë duke përdorur të dhënat nga tabela 14 për vitet përkatëse.

Shifra për IAP është thjesht një përlogaritje duke supozuar se 10% e të gjithë buxhetit të IAP i është akorduar projekteve të sanitetit.

Zëri 'donatorët e tjerë' i referohet donatorëve bilateralë (përveç BE-së), dhe supozohet se 5 milion Euro në vit do të merren nga ky burim deri në datën e pranimit në BE.

Nga këto hamendësime, boshllëku i financimit (fondet e pambuluara), që do të mbulohet nga kreditë e dhëna nga IFN-të ose institucione të ngjashme me to, do të jetë 131 milion Euro (nëse zbatimi fillon në vitin 2010) ose 47 milion Euro (nëse zbatimi fillon në vitin 2011). Mbi këto baza, një datë fillimi në 2011 duket më e përshtatshme.

Kostot për të cilat do të jetë përgjegjëse industria

Nga përlogaritjet e bëra, industria përkatëse do të ketë kosto kapitale prej rreth 38 milionë dhe kosto operative me përafërsisht 2 milion në vit si rezultat i kërkesës për të para-trajtuar ose trajtuar ujërat e ndotur nga industria. Presupozohet se industrisë do t'i jepet një periudhë tre-vjecare për të respektuar kërkesat e reja menjëherë pasi ato të prezantohen. Mund të jetë e mundur që këto kosto t'i kalohen klientëve / konsumatorëve. Shkalla në të cilin këto stabilimente janë në gjendje të kalojnë kostot e tyre të rritura tek çmimet e produkteve të tyre do të varet nga niveli në të cilin ata janë çmim-përcaktues apo çmim-pranues. Duke presupozuar që shumica e konkurrentëve deri atëherë do të jenë të vendosur tek shtetet anëtare (ose shtetet që përgatiten për anëtarësim), dhe që rrjedhimisht do të duhet t'i nënshtrohen kërkesave të njëjta, nuk do të ketë asnjë humbje nga avantazhi konkurrues në përgjithësi.

4.3 Përfitimet

Me pak fjalë mund të thuhet që zbatimi i direktivës do të rezultojë në një reduktim të dukshëm të sasisë së ndotësve të cilët aktualisht shkarkohen në ujërat sipërfaqësorë të futura në tokë (rripat ujqorë), ujërat bregdetare, ligatina, horizontet ujëmbajtëse nëntokësore dhe tokë. Shkarkimi i ujërave të ndotur përfshin mbetjet organike të biodegradueshme, substancat e rrezikshme organike, metalet e rënda dhe lëndët ushqyese.

Përfitimet e lidhura me zbatimin e Direktivës 91/271/KEE (siç amendohet nga Direktiva 98/15/KE) janë:

- Ndotja nga shkarkimi i ujërave të ndotura në trupat ujqorë do të minimizohet, gjë që do të përmirësojë shëndetin (reduktimi i sëmundjeve që vijnë nga uji) duke sjellë një efekt pozitiv në ekonominë kombëtare;
- Mjedisi ujqor do të jetë më i mbrojtur ndaj ndotjes nga substancat e rrezikshme dhe do t'i afrohet më shumë gjendjes së tij origjinale, duke siguruar kushte më të mira jetese si për jetën ujqore, ashtu edhe për kafshët dhe zogjtë tokësorë;
- Trupat ujqorë sipërfaqësorë do të ofrojnë për publikun mundësi më të mira për të kaluar kohën e lirë, gjë që do të përmirësojë sektorin e turizmit, duke gjeneruar rrjedhimisht vende pune dhe të ardhura shtesë, nga të cilat do të ketë përfitime në ekonominë kombëtare;
- Kosto të reduktuara për trajtimin e ujit të pijshëm të nxjerrë nga ujërat sipërfaqësorë.

Përfitime të tjera indirekte janë:

- Direktiva do të plotësojë dhe më tej do të përmbushë pjesë të tjera kryesore të legjislacionit që kanë të bëjë me ujin. Në veçanti, Direktiva Kuadër mbi Ujin (2000/60/KE), Direktiva mbi Nitratet (Direktiva 91/676/KEE) që ka të bëjë me ndotjen nga bujqësia, tërësia e rregullave që udhëheqin autorizimin dhe përdorimin e pesticideve dhe biocideve (për shembull, Direktiva mbi Biocidet (98/8/KE)), si edhe Direktiva PKIN (96/61/KE) mbi parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes).
- Autoriteti kompetent përfiton kapacitete institucionale, administrative dhe teknike për të rregulluar dhe kontrolluar aktivitetet, strukturat dhe sipërmarrjet e lidhura me grumbullimin, trajtimin dhe shkarkimin e ujrave të ndotur urbanë dhe industrialë, në të gjithë vendin në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar.
- Autoriteti kompetent përfiton burimet e duhura dhe të mjaftueshme për të mbledhur informacion të detajuar në të gjitha aspektet e administrimit të ujrave të ndotur, dhe është në gjendje që t'ia ofrojë këtë informacion të gjithë personave dhe organizatave të duhura.
- Bashkëpunimi dhe kooperimi, në nivel ndër-Ministror, dhe ndërmjet autoriteteve bashkiake, rajonale dhe kombëtare, industrisë dhe publikut, kryhet brenda administrimit të ujrave të ndotur më mënyrë praktike, të qëndrueshme dhe me kosto efektive.

4.4 Çështjet kryesore dhe Pasiguritë

Ekzistojnë katër pika kritike kryesore të ndërlidhura me realizimin e Direktivës. Të gjithë këta duhet të zgjidhen, në qoftë se duam që Direktiva të zbatohet në mënyrë të kënaqshme:

- Disponueshmëria e kapitalit
- Qëndrueshmëria financiare e sektorit të trajtimit të ujërave të ndotur
- Decentralizimi dhe reforma në sektorin e ujit
- Kapacitetet në Bashkitë

Siç do të shihet më poshtë, këto katër fusha janë të ndërlidhura.

Disponueshmëria e kapitalit

Realizimi i kësaj Direktive do të jetë shumë i kushtueshëm, dhe kërkon shpenzime kapitale përafërsisht prej 2,400 milion Euro, për t'u përballuar me kërkesat konkurruese nga të dy sektorët mjedisorë dhe nga pjesa tjetër e ekonomisë.

Siç u pa në analizën në fund të pjesës 3.6, veçanërisht e vështirë do të jetë periudha deri në datën e pranimit, megjithë afatin e shtyrë të periudhës së zbatimit, pasi burimet financiare të mundësuar nga BE do të jenë relativisht të kufizuara në atë periudhë, dhe do të duhet të ndahen ndërmjet një numri të madh projektsh konkurruese.

Gjithashtu, ekziston rreziku që IFN-të dhe bankat tregtare mund të dekurajohen në lidhje me dhënien e kredive për shkak të gjendjes së

tranzicionit në të cilën ndodhet decentralizimi (për shembull kompanitë e shërbimeve të ujit zotërohen nga bashkitë, por financiarisht nuk kontrollohen ende nga ato). Po kështu, do të jetë më e vështirë, të paktën në fillim, për bashkitë që të plotësojnë kriteret e kredive të ofruara nga kredidhënësit, gjë që rrjedhimisht e ndërlikon problemin përkohësisht.

Do të jetë shumë imperative (e domosdoshme) që Shqipëria të përdorë me efikasitet ato burime të cilat janë potencialisht në dispozicion të saj. Kjo do të thotë se duhen fituar aftësi për të përgatitur projekte me baza të forta e të pranueshme si edhe aplikime për financime.

Duke presupozuar që eksperiencia e rrethit të pas pranimit në BE, p.sh. SHRA-10 në 2004 është një udhërrëfyes për të ardhmen, Shqipëria do të ketë më shumë akses për financime pasi të bashkohet me BE-në.

Qëndrueshmëria financiare

Qëndrueshmëria financiare nënkupton që ndërmarrjet e ujësjellësit janë në gjendje të kenë besim se kanë të ardhura të sigurt të mjaftueshme për të shfrytëzuar dhe mirëmbajtur rrjetin ekzistues të sanitetit dhe të bëjnë parashikimin e nevojshëm financiar për investimet e ardhshme. Jo vetëm qëndrueshmëria financiare, por edhe ligji Europian kërkon që të ardhurat e gjeneruara nga sektori i përdoruesve të ujit dhe prodhuesve të ujërave të zeza janë të mjaftueshme për të mbuluar këto kosto. Një analizë e kohëve të fundit e bërë nga DPUK tregon se vetëm 2 nga ndërmarrjet e ujësjellësit i mbulojnë të gjitha kostot e tyre dhe 10 të tjera mbulojnë vetëm kostot e tyre direkte. Sigurisht që, këto kosto do të rriten në mënyrë të konsiderueshme me zbatimin e Direktivës. Kredidhënësit potencialë do të kërkojnë gjithashtu edhe qëndrueshmëri financiare si një kusht për të ofruar kredi.

Norma sipas së cilës do të kryhet faturimi i plotë i kostove sigurisht që has në kufizime që lindin nga çështja e përballeshmërisë së tarifave. Tarifat nuk mund të rriten në mënyrë të menjëhershme që të bëhen të papërballeshme për një numër të madh familjesh. Dhe, për familjet me të ardhura të ulëta, për të cilat është e pamundur të përballojnë tarifën e rritura, nuk duhet të jenë kompanitë e shërbimeve të ujit ato që do të bëjnë provigjone sociale. Një kriter që përdoret shpesh në lidhje me përballeshmërinë ka të bëjë me faktin se, që të jenë të përballeshme, tarifat për ujin nuk duhet të kalojnë 5% të të ardhurave. Sistemet novatore për tarifim të ujit mund të ndihmojnë për këtë problem. Për shembull, struktura e tarifave duhet të bazohet në konsumin e matur të parë të ujit në muaj (i mjaftueshëm për nevojat bazë) i cili ofrohet pa ndonjë kosto dhe me një normë më të lartë më pas për pjesën tjetër të konsumit⁹.

Është bërë progres drejt lejimit të kompanive për të arritur qëndrueshmëri. Kjo përfshim dhënie të drejtës bashkive për të vendosur vetë tarifën e pikat e referimit si dhe vendosjen e tyre nën presion për të zhvilluar plane biznesi pesë-vjeçare, objektivi kryesor i të cilave është të reduktojnë ose eliminojnë nevojat e tyre për subvencionime operative. Megjithatë, presioni për të arritur këtë duhet të vazhdojë.

⁹ Ky koncept është shqyrtuar nga Banka Botërore në projektin e saj *Projekti për Ujërat Bashkiake dhe Ujërat e Ndotur*, i cili përfundon së shpejti.

Decentralizimi dhe reforma në sektorin e ujit

Decentralizimi dhe reforma në sektorin e ujit aktualisht janë në një fazë tranzicioni. Progresi është më i ngadalshëm se sa ishte parashikuar fillimisht. Është e rëndësishme që të mos lejohet që procesi të mbetet në vend, për shkaqet e përmendura diku tjetër.

Kapacitetet në Bashkitë

Në të ardhmen bashkitë dhe ndërmarrjet e ujësjellësit do të kenë një marrëdhënie të re. Bashkitë do të duhet të pranojnë përgjegjësinë financiare përfundimtare për ujin, duke përfshirë këtu edhe investimin. Ato duhet të kontrollojnë ndërmarrjet e ujësjellësit ashtu siç bëhet aktualisht nga DPUK. Kjo nënkupton se ato do të duhet të fitojnë aftësi të reja saktësisht në varësi të natyrës së marrëdhënies së përfshirë. Do të kërkohet ngritja e kapaciteteve të konsiderueshme për të siguruar që Bashkitë janë në gjendje siç duhet për të zbatuar funksionet e tyre të reja.

Referenca

Burimet ujore të Shqipërisë nga Agim Selenica

Vlerësimi i Pellgut Ujëmbledhës Shqiptar nga C.A. Troendle, MATCOM Corporation

Inventari i emetimeve për emetimet në ujë në Shqipëri,
Forcimi i sistemit monitorues mjedisor në Shqipëri (projekti StEMA),
Autoriteti Kontraktues: Delegacioni i Komisionit European në Shqipëri
PM, Syke, Prospekt, Tetor 2008

Programi i monitorimit të cilësisë fiziko-kimike të ujit dhe hidrobiologjisë në Shqipëri – Master plani,
Forcimi i sistemit monitorues mjedisor në Shqipëri (projekti StEMA),
Autoriteti Kontraktues: Delegacioni i Komisionit European në Shqipëri
PM, Syke, Prospekt, Tetor 2008

Popullsia e Shqipërisë (12 vëllime)
INSTAT 2004

Treguesit sipas prefekturave
INSTAT 2008

Vlerësimi Mjedisor i Cilësisë së Ujit në Lumenjtë Shqiptarë
A. Çullaj, A. Miho, P. Lazo (Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës)

Baseni Ujëmbajtës i Elbasanit, Shqipëri dhe problemet e administrimit të tij
Petraq Naço, Enton Bedini, Rakip Hysenaj (Instituti i Kërkimeve Gjeologjike, Tiranë, Shqipëri)

Shqipëri – Projekti mbi ujërat bashkiakë dhe ujërat e ndotur – Kuadri i planit të administrimit mjedisor
Banka Botërore

Analiza e performancës mjedisore – Shqipëri
Komisioni Ekonomik për Europën, Komiteti për Politikat Mjedisore
Kombet e Bashkuara, 2002

Takim konsultues mbi Administrimin e Integruar të Basenit të zgjeruar të Lumit Drin
KB/KEE, Partneriteti Mesdhetar për Ujërat Globale

Tiranë, Shqipëri, 24 Nëntor, 2008

Reforma në Sektorin e Ujësjetës Kanalizimeve pas Proçesit të Transferimit të Kompanive të Ujësjetës Kanalizimeve tek Autoritetet e Pushtetit Vendor, Plani Dy Vjeçar 2007 – 2009

Prof. Dr. Sali Berisha, Kryeministër i Shqipërisë, 23 July 2008

Studimi mbi plan zhvillimin e sistemit të kanalizimeve dhe impjantit për trajtimin e ujërave të zeza për Tiranën e Madhe – Vëllimet I, II, III
Nihon Suido Consultants Co. Ltd., Tokyo Engineering Consultants Co. Ltd.
Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetës Kanalizimeve (DPUK), Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Republika e Shqipërisë
Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (AJBN), Mars 200

